




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.09.2020**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar **Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!
Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:



REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratimin e Buxhetit për vitin 2021,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Rregullores Komunale për Tatimin mbi Pronën e paluajtshme për vitin 2021,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Rahovecit z. Tomor Kotorri,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për caktimin e komisionit ad-hoc për zgjedhjen dhe zëvendësimin e anëtarit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe,
7. Raporti i Performancës komunale janar – dhjetor 2019.

Të nderuar kolegë kuvendarë, a pajtoheni me rendin e ditës. Atëherë konstatohet se unanimisht aprovohet trendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, a keni diçka sa i përket procesverbalit, nëse jo e qesim në votim. Atëherë konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Siç e dimë, mësimi në shkollat tona për këtë vit shkollor ka filluar me 14 shtator, pra të gjithë ju gëzuar dhe urojmë të jetë një vit i mbarë për të gjithë. Pyetja ime është se a janë të pajisura shkollat me aparate për fotokopje kur dihet se ka pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen për këtë vit shkollor dhe pa këto aparate nëse nuk janë përgatitur pengohet puna nëpër shkolla si për përgatitjen e testeve dhe planprogrameve.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, kryetarin, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët, gazetarë dhe ju që jeni prezentë në këtë sallë. Unë desha me ngritë çështjen e një rruge në qytetin

e Rahovecit, pra një rrugë e paasfaltuar me një segment të shkurtër që do të lidhte dy nga rrugët kryesore në qytet, pra rrugët Dëshmorët e Kombit dhe Gëzim Hamza. Kjo rrugë që pretendohet me u hapë që kalon nëpër pllacin e ish fabrikës 18 Nëntori. Kjo çështje është ngritur edhe me përpara pasi është kërkesë e banoreve të lagjes së rrugës Dëshmorët e Pashtrikut që është një lagje shumë e madhe. Po ashtu ka qenë kërkesë edhe gjate dëgjimeve publike nga ana e këshillit të lagjes dhe mendoj se kishte me qenë një punë shume e mirë nëse arrihet kjo rrugë të hapet. Edhe ne te kaluarën kur e kemi diskutuar këtë çështje nga kryetari kemi marrë disa premtime dhe është thënë se është në procedurë e sipër dhe pyetja është se a është punuar diçka ne këtë drejtim dhe deri ku është arrite pasi kish me qenë shume mirë për qytetin dhe lagjen nëse kishte me u hapë kjo rrugë.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë, unë kam 3 pyetje, pyetja e parë ka të bëjë me ndriçimin publik ku në disa fshatra të komunës së Rahovecit është jo funksional e sidomos në fshatin Fortesë ku me javë të tëra nuk funksionon. Deshta të pyes drejtorinë përkatëse se kush është kompetent për mirëmbajtjen e ndriçimit publik. Pyetja e dytë është se kur do të fillojë vazhdimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit në Fortesë pasi është shqetësuese për banoret e këtij fshati, pasi dihet arsyeja se jemi në kohë vjeshte që reshjet atmosferike janë me te mëdha kështu që çdo vite po përballemi me të njëjtin problem. Po ashtu i drejtohem drejtorisë së inspektionit, ku përgjatë rrugës Fortesë Xerxë, në anën e djathtë në hyrje të Xërxes afër rrugës se asfaltuar në tokë bujqësorë shihet se është duke u punuar diçka me beton. Pyes drejtorin se a është në dijeni për këtë rast?

Rexhep Oruqi – Unë po e ngrisë çështjen e stacionit të autobusëve në cilësinë e njërit prej aksionareve, pasi jemi të tretë këtu, pra Përparim Krasniqi i emëruar nga Kryetari i Komunës pastaj Hanalora Hoti që përfaqëson grupin e LDK-së dhe unë në emrin e grupit të PDK-së. Vendimi është sjellë në muajin prill të vitit 2018 dhe është shndërruar në pronë komunale pasi është bërë një punë e mirë sepse për shkak të obligimeve që i ka pasur ndaj ATK-së si dhe ndaj strukturave të tjera është dashtë me shkua edhe ne likuidime që dikush e kish përvetësua për një shumë të vogël. Tani janë kryer disa procedura edhe është regjistruar si biznes i ri në emër të komunës si Stacion i Autobusëve ku është zgjedhur bordi dhe udhëheqësi i përkohshëm si Ushtrues Detyre dhe është regjistruar si biznes dhe në fakt po funksionon me vështirësi të mëdha që e kanë përcjellë me vite të tëra. Borgjet që janë ndaj ATK-së tash i kemi si komunë, do të ishte mirë që kryetari me disa prej aksionareve dhe me autoritetin që posedon që me shkue në ATK dhe me kërkuar shlyerjen e këtij borgji ose eventualisht të riprogramojmë gradualisht se do të ketë pengesa për shkak të bllokimit të llogarive rrjedhëse që duhet të funksionojë. Po ashtu komuna në kuadër të stacionit për brenda i ka 3 objekte që ju ka dhënë bizneseve, në fakt ju ka dhënë hapësirën që ata kanë ndërtua disa objekte që ata me funksionue, që në seancën e radhës të marrim një vendim që ti shfrytëzon stacioni i autobusëve pasi edhe ashtu janë në krizë. Afërsisht 100 euro i kanë të hyrat ditore kështu që me 3000 euro mujore nuk kanë mundësi me i mbulue të gjitha shpenzimet. Do të ishte mirë që në seancën e radhës të merret një vendim që të ju mundësohet të marrin qiranë edhe ashtu shuma e qerasë është e vogël, që realisht atyre do të ju ndihmojë shume kurse komunën nuk e dëmton asgjë.

Hanalora Hoti – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë desha me ngritë një kërkesë që tash në këto ditë që po vazhdon me reshje kemi grumbullime të mbeturinave të shumta nga qytetaret e papërgjegjshëm të cilët po i hedhin vazhdimisht në përroin i cili kalon tek ura e poshtme në Ratkoc. Është pakënaqësia e atyre qytetarëve të cilët me shtëpitë e tyre janë afër përroit dhe kërkojnë nga kompania e pastrimit që të ndërmarrë veprime. Një tjetër çështje është folur edhe për ndërtimin 17 rrugëve në fshatin Ratkoc dhe jemi në përfundim të muajit shtator dhe punimet ende nuk kanë filluar dhe desha të di arsyen nga drejtori i Shërbimeve Publike.

Ali Zhuniqi – Unë fillimisht do të nisem me drejtorinë e Arsimit ne lidhje me konkursin e fundit që mendojmë që është bërë një shkelje ne lidhje me largimin arsimtarit në shkollën Isa Boletini, edhe përgjigjen që kam marr nga drejtori nuk ka bazë ligjore dhe argument dhe është e pabazuar, pasi në

konkursin e fundit e kemi cekë edhe me herët në lidhje me problematikat që kanë ndodhur me atë konkurs, madje në seancën e kaluar e kemi ditur edhe personin që do të pranohet dhe ajo është e identifikuar edhe në procesverbal dhe për këtë arsye mendoj që është bërë një e padrejtë, me pak kur me ligje duhet që drejtori duhet paraprakisht ta njoftoj pavarësisht që ka pasur një afat të caktuar në kontratë dhe në bazë të ligjit duhet 30 ditë përpara që punëdhënësi të njoftojë punëmarrësin për largim nga puna dhe në të njëjtën kohë d.m.th. kjo nuk ka ndodhur. Madje kjo shkon edhe me larg që për të njëjtën pozitë në shkollën Isa Boletini i jepen orët një personi me emër e cila është Drenusha Selmançena, e cila ka qenë në konkursin e fundit të hapur nga DKA-ja, e fundit në listë me më së paku poena dhe nuk e di sa është kjo e vërtetë dhe në bazë informacioneve që ne posedojmë flitet për këtë lloj rasti dhe kisha kërkuar nga drejtoria e Arsimit të na jep sqarime pak më shumë. Po ashtu në konkursin e fundit për dhënien e bursave studenteve, ku në konkurs thuhet që të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentet të cilët studiojnë në universitete publike të Kosovës dhe ndërkohe në listën e studenteve të shpallur nga DKA-ja që janë përfitues të bursës, identifikohen dy studentë që studiojnë jashtë vendit. Dhe unë dua të di që a është në rregullore për subvencione që të jepen edhe bursa studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit pasi që kjo shkon nëpërmjet Ministrisë së Integritetit Evropian që zakonisht ata japin bursat dhe bëhet aranzhimi për studentë që studiojnë jashtë vendit dhe si i tillë, ne konsiderojmë që është shkelje e rregullores dhe e ligjit dhe po ashtu në të njëjtën kohë shkon edhe më larg, kur një zyrtar i Arsimit para fillor, ku motra e saj që studion jashtë vendit të merr bursë nga ana e komunës dhe kjo është konflikt interesi direkt dhe ne konsiderojmë që është shkelje dhe për këtë arsye kërkojmë nga drejtoria e Arsimit që të përgatitë në mbledhjen e ardhshme në lidhje me dhënien e bursave dhe të na tregoj të gjitha kontratat që ka nënshkruar me të gjithë ata studentë që janë përfitues të bursave.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, anëtarët e kuvendit komunal, përfaqësues të LMT-së, OSBE-së, mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë kam dy pyetje, e para lidhet me rrugët në komunën e Rahovecit dhe pyetja e dytë lidhet me serat për vitin 2020 që kemi pasur me i ndërtua. Rreth pyetjes së parë, segmenti gjegjësisht rruga Fortesë- Krushë e Madhe në disa segmente është shume e dëmtuar sa vërtet është bërë e bezdisshme për qytetarët që kalojnë atypari, pasi vërtet u bë vështirë me kalua në disa vende dhe këtë çështje e kemi diskutuar disa herë dhe kemi pasur premtime nga drejtoria e Shërbimeve Publike se do të bëhet diçka mirëpo deri më tash nuk është bërë asgjë. Unë nuk do t'i fajësoj pasi shumë gjëra varen nga buxheti por kërkoj që vërtet të mbetet pak më e përshpejtuar dhe të kryhet kjo punë pasi në disa segmente është bërë e pakalueshme kështu duhet të rregullohet sa më parë sidomos në dy apo tre segmente urgjentisht të intervenohet deri sa të vinë kushtet për me u rregullua krejt ajo rrugë. Po ashtu në skaj të rrugës sidomos tek vendi Mulliri po grumbullohet uji nga shirat atmosferike dhe dheu është vendos gati mbi sipërfaqen e asfaltit dhe nga makinat po mbesin në ujin e grumbulluar dhe është mirë që në atë pjesë me marrë masa që me intervenua disi. Pyetja e dytë ka të bëjë me serat pasi ne në vitin 2020 kemi ndarë një buxhet për serat me participim me qytetarët e komunës tonë dhe vetëm desha me ditë se deri ku kemi mbërri pra ku ka mbet çështja se a janë kryer të gjitha apo jeni duke vazhduar me ndërtimin e tyre.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive komunale, kolegë asamblastë, monitorues të kësaj seance. Para disa dite është bërë përrurimi i ndriçimit publik në fshatin Dobidol, për të cilin projekt e përgëzoj kryetarin dhe ekzekutivin e tij pasi është një projekt i rëndësishëm por ajo që më ka rënë në sy është se tash e disa ditë trotuari i cili është dëmtuar gjatë vendosjes së ndriçimit publik nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme. Këto ditë ka filluar edhe procesi mësimor edhe po shkakton shume telashe për nxënësit që po kalojnë aty. Ftoj drejtorin e Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi që të konsultohet me operatorin dhe të kthehet trotuari në gjendjen e mëparshme dhe të mos lejojme që të shkatërrohet sikur një pjesë tjetër që është shkatërruar nga KRU-Gjakova dhe nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme asnjëherë.

Munib Durguti – Faleminderit i nderuari kryesues, kryetar dhe gjithë ju të pranishëm. Unë desha të ndërlidhem me projektin që është përfunduar dhe gjegjësisht kanalin nëntokësor i cili do të ndërtohet nga pompa e benzinës për shkarkimin e ujërave të shiut në lumin Dullo. Kujtoj se këtu ndjekim me shqetësim këtë projekt dhe banoret e lagjes jo pa arsye janë të shqetësuar për këtë projekt që do të realizohet. Ne e dimë që tani kontrata është e lidhur dhe nuk e kemi për qellim me pengua këtë projekt mirëpo propozoj meqenëse është seanca e buxhetit që në pikat ku do të kyqet ai kanal të bëhet një projekt dhe të hapet një kodë i ri për thellimin e shtratit të lumit. Po ashtu propozojmë që kyqja të bëhet sa me poshtë afër stacionit të autobusëve apo ku ju e shihni me përshtatshëm dhe të hapet një projekt me një fond modestë, në mënyrë që të përcillet vitin e ardhshëm me një buxhet me të qëndrueshëm. Tani nuk keni nevojë me prishë komplet kanalin por vetëm një thellim pra kaskadë që po besoj do të kishte kryer punë dhe do të ishte i mjaftueshëm edhe sigurisht me mjete pak. Kjo është kërkesa dhe ju kisha lutë që ta shqyrtoni dhe ta merrni me seriozitet ngase shtrati aktual nuk ka kapacitet për ujërat që vinë aty e assesi ujërat e qytetit t'i përfshijmë në atë shtrat. Sa për informacion për shkak të reshjeve që kemi pasur sivjet, aty disa familje janë vërshuar do të thotë vetëm me ujërat aktual që kalojnë në lumin Dullo, pra kemi pas vërshime në disa familje në lagjen Canziba dhe uji ka hyrë jo vetëm në oborr por edhe brenda në shtëpi, pasi nëpër oborr është çdo here sa kemi reshje të mëdha atmosferike. Dhe tash nëse ne bëjmë kyqjen e këtij kanali që është me kapacitete 2 metra me 1.5 metër atëherë vërtet kemi rrezikue jashtëzakonisht shume, kështu që propozoj që të hapni një kodë dhe aty ku do të bëhet kyqja duhet të bëhet trajtim i serishëm i shtratit të lumit Dullo.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për kryesuesin, kryetarin, nënkryetarin, kolegë kuvendarë, media, përfaqësues të LMT-së dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Unë e kam një pyetje rreth një shqetësimi jo vetëm për mua por për gjithë qytetaret e komunës së Rahovecit. Desha të pyes kryetarin se para disa dite lexova në rrjetet sociale rreth çështjes së Basketbollit ku kryesia kishte dhanë dorëheqje dhe sa e di unë një takim është deshtë me mbajtur edhe me juve kryesia e Basketbollit pasi e dimë se klubi i Basketbollit gjithë qytetaret e komunës së Rahovecit jemi mburrë jo vetëm në nivele shtetërore si ekip fenomenal por edhe me rezultate shumë kulminante të cilët i kanë arritur. E kisha lutur kryetarin që të bëjë zgjidhje maksimale që të ndajë mjetet buxhetore në maksimum aq sa ka mundësi normal edhe të ftojë që të bashkëbisedoj me kryesinë dhe me gjithë donatore tjerë të mundshëm të cilët e kanë mbështetur klubin mirëpo tani si po dëgjoj që janë tërhequr apo do të tërhiqen dhe mos të mbetet klubi i Basketbollit të marrë kahjen e klubit të futbollit të Rahovecit që është e turpshme për të gjithë neve kryesisht dhe jo për lojtarët aty se në çfarë rangui të ligës ka mbetur. Kështu që kemi të vetmin klub me të cilin mburremi në nivel shumë të lartë kështu që kërkoj që gjithsesi me mjete maksimum të mundshme edhe duke shfrytëzuar edhe autoritetin e vet tek donatorët e tjerë të mundshëm dhe të vazhdon pasi ne jemi mburrur dhe kërkojmë që mburremi përsëri me klubin e basketbollit por edhe me të gjitha klubet që gravitojnë dhe marrin pjesë në komunën e Rahovecit edhe kryesisht aty ku i kemi rezultatet kulminante që të bëjmë çmos dhe ta ndihmojmë.

Besa Bytyqi - Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive. Kolegë këshilltarë. Unë kam dy çështje me rëndësi, ku nga dëgjimet buxhetore të mbajtura në kuadër të KPF-së, Këshilli i fshatit në Opterushë përveç tjerave ka cekur edhe dy çështje tejet problematike për fshatin. E para është kyqja e fshatit në KRU-Gjakova sepse uji i vrellës ka prani të madhe të gëlqerës dhe shtrirja e tensionit të lartë të energjisë nga Rahoveci në drejtim të Opterushes. Pra këto dy çështje prioritare kanë qenë për këshillin e fshatit dhe gjithë banoret. Ndërsa edhe këshilli i fshatit Reti e Ulët ka paraqitur po në atë takim disa prioritete e me theks të veçantë meremetimi i shkollës, sinjalizimi i rrugëve dhe pastrimi i gropës septike. Dua një përgjigje për të gjitha këto problematika se çfarë është ndërmarrë dhe kur priten të zgjidhen këto probleme.

Aferdita Thaqi – Unë kam një vërejtje për komisionin për emërtimin e rrugëve që kryesuesja e zgjedhur ta mirëfilli propozimin e Vahid Krasniqit që është i zgjedhur nga LDK-ja që të dalin në terrene dhe të marrin mendimet e qytetarëve për emërtimin e rrugëve.

Kryetari – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, bashkëpunëtor drejtor, anëtar të kuvendit të komunës së Rahovecit, përfaqësues që po e përcejellin këtë seancë nga shoqëria civile, nga mediat, nga LMT, OSBE-ja dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Unë do të rezervohem në pyetjen e parashtruar nga Rexhep Oruqi për çështjen e Stacionit të Autobusëve dhe ajo që e di unë është se po presim me lidhë kontratën edhe me fillua riparimin e Stacionit të Autobusëve ndërsa pjesën tjetër do ta shpjegoj drejtori i shërbimeve publike Përparim Krasniqi, sikurse që do të rezervohem që ti jep përgjigje ndoshta edhe aspektit që ka të bëjë sa i përket rrugës Fortesë – Celinë, në ato pjesë që janë shumë të dëmtuara edhe që ka dhënë një zotim dhe ju kemi bashkuar gjithë atij zotimi për shkak se ka nevojë të intervenohet urgjentisht në sanimin e asaj rruge, pra sigurisht edhe këtu do të përgjigjet drejtori i Shërbimeve Publike Përparim Krasniqi në pyetjen e parashtruar nga Rasim Fazliu. Pastaj në pyetjen e parashtruar nga Florida Bajraktari se a janë të pajisura shkollat me aparate për fotokopje. Sa për sqarim për këtë pyetje sepse sigurisht që është shqetësim edhe për ne si udhëheqje komunale, ku fatkeqësisht janë centralizua furnizimet me aparate fotokopjuese dhe materiale tjera informative që ka 5 vite që nga qeverisja e Idriz Vehapit si kryetar dhe nuk e di pse ka ndodhur kjo dhe ne kemi vështirësi në furnizim me aparate për fotokopje e madje edhe në objekte komunale e mos të flasim për furnizim nëpër shkolla. Pra është detyrë e jona me bo presion por ne nuk jemi autoriteti kontraktues pra ne nuk jemi në nënshkrues të kontratës por Ministria e Punëve të Brendshme, departamenti i Administratës Publike dhe sigurisht që u deshtë me ndërhyje sepse vërtet kemi mbete shumë keq edhe në komunë sa i përket aparateve fotokopjuese. Tash paksa ka fillua me u përmirësuar në komunë por ka ngecje nëpër shkolla. Kjo është përgjigja që neve na obligon që edhe njëherë me u rikthye kësaj çështje edhe me kërkua me bo presion për furnizim me të mirë për aparatura neper shkolla tona. Çështja e rrugës së pandërtuar të fabrika e plastikes apo 18 Nëntori, kuvendi i komunës ka marr vendim edhe më herët pasi është një proces që ka zgjatur edhe po zgjat përsëri pra ende jemi në proces dhe ende departamenti për shpronësim ka bërë një vlerësim të pronës dhe palët nuk janë pajtuar dhe janë në procedura pasi ka mospajtim për shumën që ata kanë dhënë departamenti për shpronësim kështu që çështja ka ngecur, pra ne presim që sa më shpejtë që të merret epilog pozitiv edhe natyrisht të hapim atë rrugë pasi është vërtet shumë e rëndësishme pasi lidhë dy lagje por ishte edhe kërkesë edhe nga vet aksionaret e fabrikës, pra ka mospajtim me shumën e parave që departamenti për shpronësim kur e ka bërë vlerësimin nuk janë pajtuar me atë shumë. Pastaj ndriçimi publik në Fortesë, ju e dini se ne kemi kontratë për ndriçim publik dhe e dimë që ndriçimi publik në Fortesë është i vjetër dhe ka probleme të mëdha teknike por aty ka probleme më të mëdha se që mund t'i përmbushë një kujdestari e zakonshme. Ne do të intervenojmë edhe në Fortesë me ndriçim publik sikurse edhe në çdo lagje të qytetit edhe në çdo vendbanim të komunës së Rahovecit, që fatbardhësisht kemi kontratë por edhe operatorët nuk kanë fuqi të kapaciteteve të mëdha që me i krye punët me shpejtë për shkak të numrit të vogël të punëtorëve por shpresoj që shumë shpejt do të rregullohen pasi për momentin jemi duke punuar në qytet dhe do të vazhdojmë edhe nëpër çdo vendbanim të komunës tonë pasi kontrata na mundëson me investua edhe sigurisht me i riparua vendet veçse janë me ndriçim publik dhe nuk ka nevojë me u investua por edhe me bo ndriçim të ri publik me ato kanale nëntokësore. Sa i përket pyetjes se parashtruar për lumin Rimnik, ne jemi në proces të vlerësimit dhe shpresojmë që të mos ketë ankime nga ana e dikujt edhe jemi në pritje të nënshkrimit të kontratës i cili nënkupton riorganizim të shtratis pra kolektorit të ujërave të zeza dhe zgjatje në të dy anët edhe në pjesën për Celinë ka lumi Bellaja edhe në pjesën për Rahovec, e madje do të ketë zgjatje edhe në pjesën për Sopniq. Pra në disa segmente do të jetë projekt i ri ndërsa në pjesën ekzistuese ku ka probleme me kanalizimin e ujërave të zeza do të ketë ristrukturim të krejt asaj që është me defekte dhe besoj që është një projekt i mirë dhe nuk e di sa do të jetë i kushtueshëm pasi presim me nënshkrua kontratën edhe shpresojmë që do të kujdesemi që edhe punët me fillua sa me shpejtë që është e mundur. Ndërtimi ilegal në Xerxë, unë e di që shumë më mirë do të përgjigjej se sa unë, drejtori i Inspektoratit por e di që kemi të bëjmë me një ndërtim jo vetëm ilegal pasi me ka detyrua edhe mu me u përfshijë direkt, pasi ai ndërtim ilegal nuk do të ndodhë dhe ai operator që ka krye

punën e ka marr gjobën mandatorë 1000 euro dhe jemi në procedurë të rrënimit, pasi bëhet fjalë për një ndërtim jo vetëm ilegal por edhe kriminal. Pasi ka pranua kërcënime edhe drejtori po ashtu edhe inspektorati dhe ne jemi në mbrojtje edhe ne zbatim të ligjit dhe jemi për me zbatua ligjin secili prej nesh dhe tash natyrisht ne jemi autoriteti që do të kujdesemi dhe besoj që duhet me dhanë ndihme edhe asambleja kur ka raste problematike. Pra ky ndërtim nuk do të ndodhë pasi vetëm të këqija do të prodhon nga ajo që kanë planifikua me ndërtua, pasi njerëz nga vende të ndryshme të Kosovës edhe sillen këtu si kriminel, ne nuk do të lejojmë të ndërtohet ajo dhe shpejt keni me pa që ai beton që u vendos aty ditën e diele dhe menjëherë jemi përfshier me gjithë kapacitetet bile kam dhanë edhe një vërejtje për policinë pasi ka hezitur me intervenua menjëherë kështu që tani edhe me policinë jemi marr veshë dhe nuk do të ndodhë ndërtimi ilegal dhe do të rrënohet krejt ajo që u ndërtua aty. Pastaj pyetja e drejtuar nga Hanalora Hoti për mbeturinat, e pranoj se ende kemi problem me mbeturinat edhe në Ratkoc e madje edhe ne qytet, në lumin Dullo edhe sigurisht edhe në përroje edhe ne lumenjë të tjerë nga njerëz të papërgjegjshëm. Kemi fillua me pastrimin apo heqjen e deponive ilegale në mënyre vullnetare ndoshta pa pasur nevojë edhe me shpenzua edhe mjete financiare por këtë nuk mundemi ta përsërisim ne vazhdimësi dhe ne po përpiqemi me u sigurua që jo vetëm me lanë në ndërgjegjen e njerëzve por edhe me fuqizua inspektimet edhe pse numri i inspektoreve është i kufizuar dhe nuk po mundemi me mbërrir ende me i disiplinua apo me i gjobitë ata që i kryejnë këto punë që hedhin bërlllok në përroje në lumë apo edhe ne vende tjera që janë të ekspozuara. Kemi operatorë për mirëmbajtje apo pastrim të përrojeve por edhe ka ndodhur pastrime neper të gjitha këto vende por përsëri po gjendemi përballë elementeve të papërgjegjshëm që po e kryejnë punën në mënyrën me te keqe të mundshme dhe po hedhin mbeturina neper shume vende dhe po kemi vazhdimisht telashe. Unë besoj që do të kemi pastrim përsëri edhe të atij përroji por edhe të përrojeve tjera edhe për shkak se jemi duke hyrë në stinën e vjeshtës dhe të dimrit. Pastaj tek pyetja e parashtuar nga Ali Zhuniqi, rreth bursave për studentë, ne i kemi 154 numrin e studenteve bursistë përfitues dhe jemi munduar maksimalisht që komisioni me i respektua kriteret madje ka pasur edhe një verifikim ku me iden ma të mirë që me ju dhanë maksimalisht studenteve pasi jemi edhe ne kohe pandemie dhe kanë rezultuar që mbi 14 studente e kanë përsëritur vitin dhe jemi detyruar me i largua edhe mos me i ekzekutua pagesat edhe pse kanë dalë në listën e përfituesve. Unë nuk jam kundër edhe po besoj që edhe ju nuk jeni kundër me ju dhanë bursa edhe atyre që studiojnë jashtë Kosovës, pra është e njëjta shumë edhe për ata në shumën prej 450 euro për një vit. Pra kemi dashtë me reflektua një pozicion që njerëzit që po shkollohen jashtë të trajtohen të barabartë, e dimë që Ministria e Arsimit apo e Integritimeve evropiane japin bursa tjera dhe me vlera shume më të mëdha, por ne kemi deshtë që së paku dy studentëve por jemi të gatshëm edhe të tjerëve me vendim të kryetarit si subvencion që me ja bo një ndihmë një studenti që studion jashtë Kosovës. Nuk besoj që në parim është në kundërshtim me rregulloren sepse po e marr një shembull se komuna e Obiliqit vetëm se e ka ligjin për Obiliqin mbi 5 milion shtesë ka mbi 2000 euro bursë për studentë por ka bursa edhe për nxënësit e talentuar të shkollave të mesme ju jep pasi ka edhe subvencione me vlerë mbi 800,000 euro subvencione dhe duke marrë parasysh se sa e vogël është komuna e Obiliqit. Pra rregullorja për shpërndarjen e bursave nuk është që na vendos barriera për me ju ndihmua studentëve që vërtet dëshmojnë që janë duke studiuar jashtë. Pra nga 192 aplikues, prej tyre janë 154 përfitues por dëshira e jonë sigurisht që ka qenë me ju dhanë 192 aplikuesve por mundësitë nuk na kanë lejuar dhe atëherë përzgjedhja dhe vetëm pak studente janë eliminuar pra ata që e kanë përsërit vitin dhe që janë dy prej një familje. Sa për konflikt interesi, unë ju siguroj që kemi edhe anëtare të kuvendit të komunës dhe ju siguroj që prej familjes time askush nuk ka aplikuar, pra nuk është bërë përzgjedhja në bazë të kriterëve në baza familjare dhe po besoj që as unë dhe i gjithë ekzekutivi nuk e kanë dikën të familjes përfitues që me pas konflikt interesi por në bazë me te gjere mund të kenë studente që mund të interferojnë ne lidhje familjare dhe nuk besoj që ka të keqe por le t jete studentë i mirë dhe le ta fiton të drejtën që mos ta përsëritë vitin dhe prape i japim dhe me automatizëm sipas ligjit sipas rregullores nëse i ka kalua këto kriterë. Jemi përpjekur me i respektua drejtimet deficitare, rastet e

familjeve skamnore po ashtu komisioni ka marr porosi ne nese i ka dy apo tre studente brenda familjes duhet me patjetër me përfitua njeri prej tyre pastaj nese është listë sociale apo familjes se dëshmorëve apo martireve duhet me përfitua , pra jemi përpjekur me u kujdes që me dërgua porosi komisionit që mos me gabua në këto raste që të ju jepet mundësia atyre që dëshirojnë me u shkollua. Pyetja e drejtuar nga Fehmi Hoxha rreth KB. Rahoveci, ju e dini se Klubi i Rahovecit na ka bërë krenar jo vetëm Rahovecin dhe komunën e Rahovecit por krejt Kosovën. Ne kemi pasur një situatë sivjet pak me ndryshe për shkak të kushteve të pandemisë dhe rrethanave që ka diktua vetë pandemia dhe kemi shkuar në drejtim të ndarjes se fondeve për mirëmbajtje të aktiviteteve potenciale të secilës OJQ subjekt apo individë që ka konkurruar. Realisht deri me tani nuk ka pasur asnjë aktivitet nga KB. Rahoveci për shkak të rrethanave të pandemisë dhe jo që ska pasur vullnet apo dëshirë por ska ndodhë. Gjithashtu ju e dini se klubit të basketbollit i ka kushtuar kujdes të veçantë edhe kryetari i juaj me ekipin e tij d.m.th. vitin e kaluar i kemi ndarë 40,000 euro dhe ne kemi pasur problem edhe me OJQ-të tjera që kanë aplikuar. Por ne e kemi zgjedhur si prioritet pasi është klub shume i fuqishëm edhe mbi bazën e argumenteve dhe i kemi ndaje 40,000 euro. Mirëpo për këtë vite edhe pse kanë konkurruar shumë OJQ, jemi përpjekur të gjithëve me ju dhanë nga pak që mos mu ndie të zhgënjyer edhe për shkak të pandemisë edhe kemi pasur një rekomandim prej Ministrisë se Kulturës që të shkohet dhe të ju jepet mundësia që se paku të mirëmbahen organizatat, shoqatat, klubet sportive, shoqëritë kulturore artistike e tjera. Për KB.Rahovecin mundësit tona kanë qenë për 22,000 euro për këtë vite dhe ata nuk e di për çfarë arsye udhëheqja e klubit kanë dhënë dorëheqje me pretekstin se duhet me ndaje mjete financiare me shume se sa janë ndarë tani. Ata duhet me qenë në dijeni se limitet apo tavanet janë caktuara dhe nuk munden me ndaje me shume se sa 22,000 euro mirëpo për 3 muaj me i ndaje komuna kaq shume një klubi nuk është edhe pak sepse është top listën me mundësi me te mëdha financiare nga komuna Rahovecit është klubi i basketbollit KB.Rahoveci kurse të tjerat kanë shumë me pak. Mirëpo ata kanë mbledhë kuvendin dhe kinse kanë dhënë dorëheqje dhe kanë dalë me komunikatë zyrtare mirëpo ne kemi pritur me nënshkrua kontratën. Sigurisht që i mirëpresim me nënshkrua kontratën dhe besoj që klubi ka me pas përkrahjen maksimale edhe ne mënyra apo forma tjera jo vetëm me i zhvillua aktivitetet e veta por me na bërë krenar edhe me tutje. Nuk ka vend për dyshime as prej kuvendit, qytetarëve tifozëve apo edhe prej lojtareve që me krejt kapacitetet që ka komuna e Rahovecit ka me mbështet klubin edhe sivjet edhe vitin e ardhshëm por duhet ta kemi parasysh se shumë qytete nuk e mbështetin me asnjë shumë klubet e basketbollit të qyteteve te tyre sepse kanë filluar me u privatizua dhe janë kthye në shoqëri aksionare por sidoqoftë ne po e ruajmë traditën dhe po e mbështesim dhe sigurisht që do të vazhdojmë me mbështet natyrisht sipas mundësive tona por edhe me ndonjë donatorë. Ju kisha drejtuar Fehmi Hoxhes se mund ju dërgoni porosinë kryesisë se Klubit të Basketbollit KB.Rahovecit mbështetjen e kanë edhe do ta kenë vazhdimisht edhe kontratën munden me ardhë edhe me nënshkrua me Kryetarin e Komunës por sigurisht se duhet dëshmuar për të gjitha aktivitetet që ushtron, edhe jeni pikërisht ju anëtarë të kuvendit që do të kërkonit raport rreth kësaj dhe unë sigurisht që do të ju paraqes dhe do të jenë të hapura. Por mos harroni se komuna e Rahovecit është ndër komunat e rralla që kaq shumë e mbështet sportin edhe sigurisht se janë të paraqitura raportet e klubeve pasi janë edhe obligative edhe sipas kontratës por duhet me ju dërgua auditim e sidomos atyre që marrin më shumë. Duke marrë parasysh gjendjen e krijuar nga situata e pandemisë dhe asnjë aktivitet nuk është zhvilluar ne palestër, duhet më shumë mirëkuptim të kihet parasysh ndarja e kësaj shume. Pra ne kemi bërë disa dallime pozitive me qellim me ju dhanë përkrahje atyre që na bëjnë krenar por duhet ta kenë mirëkuptim sa i përket ndarjes pasi duhet ta dinë se nuk e ka obligim kuvendi komunal me financua klubin pasi ajo është një OJQ që del me planin e vet dhe konkurron, por sigurisht që edhe kërkesat dhe ambiciet duhet të jenë mirëpo duhet të jenë të menaxhueshme edhe nga ana e tyre edhe nga ana jonë sepse ne kemi obligime ne radhë të parë ndaj qytetareve edhe ndaj jush si kuvendë e sigurisht edhe ndaj auditorëve. Te kanali i ujërave atmosferikë që parashtrij pyetjen asamblisti Munib Durguti, që është një shqetësim me vend dhe ne kemi nisur dje një projekt i cili shkon komfor edhe kërkesës se inxhinierëve

arkitekteve edhe konform edhe juve që keni ngritë si çështje disa herë në kuvendë dhe tani po dojmë me bo kanal të betonit me të gjitha elementet përcjellëse e gjithashtu edhe rregullimi i pushtave dhe një shkarkim të kontrolluar në lumin Duhlllo. Jemi të vetëdijshëm për gjithë këtë ujë që do të shkarkohet në kanal, që se pari mendojmë me bo një shkarkim në radhë të parë dhe do të bëjmë pozicione mbrojtëse që i japin mundësi uji me shkua teposhtë dhe mos me vërshua shtëpitë e banuara dhe me i dëmtua ekonomitë familjare. Edhe pse ka moskujdes ndaj atyre që kanë ndërtua skaj lumit e po ashtu ndoshta ka edhe uzurpime por pikërisht në skaj të lumit ka ndërtim dhe rreziku është çdo herë. Pra jemi të interesuar me rritë buxhetin për kanalin e ujërave atmosferikë dhe jemi të interesuar me i zhvillua punimet me cilësi, kontrata dhe ka filluar me u zbatua po shpresojmë që kompania e cila e ka fitua kontratën edhe që është shumë serioze pra është kompania "Mendi" edhe ka garantua se sivjet nëse ka kohë të mirë do ta kryen punën pasi sivjet do të ballafaqohemi edhe me ndalim qarkullimi në atë zonë dhe do të kemi një kujdes të shtuar aty ku shkarkohet dhe aty ku vazhdon lumi Duhlllo. Nëse urat nuk kanë qenë të kanalizuar siç e keni parë rrugët plotë në rrugën Xhelal Hajda – Toni do të kanalizohen dhe do të behet shkarkimi i kontrolluar i ujërave të zeza dhe do të kemi kujdes se çfarë do të ndodhë pas këtij shkarkimi të kontrolluar në lumin Duhlllo, që me siguri do të ketë nevojë për ndonjë mure mbrojtës, për ndonjë kaskadë apo thellim dhe unë besoj se ne do vimë edhe ne lagje me inxhinierët tanë e sigurisht se do të marrim ndonjë konsultë profesionale se ku do të shkarkohen këto ujëra. Pra jemi të shqetësuar sa i përket këtij grumbullimi të ujit mirëpo për këtë përgjigje janë të angazhuar profesionistët dhe besoj që kemi me i dhanë zgjidhje edhe këtij problemi edhe sigurisht se unë jam dakord me rritë buxhetin që ndoshta ska nevojë me hapë kodë sepse e kemi kodin edhe kontratën dhe mundemi mos me prekë fare këtë kontratë pasi kemi pozicione tjera në kontrata tjera që mundemi me i bo këto punë për të cilat nuk shpenzojmë buxhete shumë. Te pyetja e parashtruar nga Rasim Fazliu për serrat, ato kanë filluar me u ndërtua dhe janë dy operatore pra dy lote edhe po vazhdon ndërtimi i tyre dhe nuk kemi pengesa deri me tani edhe besoj që përfituesit tash gjatë kësaj faze nëse është koha e mirë dhe ne mund të ju sigurojmë se tash najlonin nuk mundemi me i vendos tash pasi janë kushtet e dimrit pasi duhet një temperaturë e caktuar por ndërtimi i serrave është duke vazhduar dhe mund të them se deri me tash janë përfunduar mbi 60 prej 300 sa do të ndërtohen prej dy operatoreve, ato janë të madhësisë 3 ari, 5 ari, 7 ari, dhe 10 ari, pra është duke vazhduar ndërtimi i serrave pasi kontrata është serioze edhe besoj që edhe serrat kanë me qenë të kualitetit të lartë. Tek kyçja e ujit në KRU.Gjakova, sinjalizimi i rrugëve në Reti dhe gropa septike ishte pyetja e parashtruar nga Besë Bytyqi, sinjalizimi i rrugëve në Reti veçse ka filluar, po ashtu edhe ndriçimi publik po bëhet ndërsa te gropa septike nuk jam në dijeni por ndoshta drejtori i shërbimeve publike është në dijeni rreth kësaj. Pastaj pyetja e parashtruar nga Ali Morina për ndriçimin publik dhe trotualet në Dobidol, është e vërtetë që operatori që e ka hapë kanalin dhe i ka futë ata gypa dhe i ka vendos shtyllat, e ka dëmtuar trotuarin dhe sigurisht se edhe duhet me riparua sa me shpejt. Pastaj pyetja e parashtruar nga Aferdita Thaqi për komisioni për emërtime duhet të dal në terrene, edhe unë mendoj se duhet me dal në terrene mirëpo sipas vendimit që na ka obliguar kuvendi i komunës në vitin 2015/16 kur ka qenë qeverisja tjetër, ne kemi për obligim me i shqyrtua paraprakisht ato që i kemi si emra rezervë që ndoshta ka plot mospajtime aty por me vendim të kuvendit të komunës të shohim se a do të mundemi me futë që janë emrat rezervë në listën e emërtimeve dhe a do të mundemi me bo ndonjë korrigjim dhe a mundemi me marr edhe emërtime të reja për pozicione të reja që me hapë kode të reja. Por do të ishte mirë ju të mblidheni si komision edhe keni për obligim prej kuvendit e që sigurisht se ju takojnë edhe mëditjet si anëtarë të komisionit sikurse i marrin edhe anëtarët e komisioneve tjera që janë të ngritura po ashtu prej kuvendit. Nuk marrin mëditje këta që janë të ngritur prej qeverisë komunale por vetëm ata që i ka themelua kuvendi pasi edhe vet keni marrë vendim vet si kuvend dhe unë e zbatoj vendimin që keni marr vetë. Unë kisha kërkuar nga drejtori i Shërbimeve Publike që me u përgjigj për çështjet që kanë të bëjnë me pyetjet që i janë drejtuar asamblistët si për gropën septike në Reti, pastaj rrugën Fortesë-Krushë e Madhe, pastaj për ndriçimin publik, trotualet, stacionin e autobusëve. Po ashtu edhe për pyetjen e parashtruar nga Hanalora

Hoti për ndërtimin e rrugëve, unë mendoj që është fatbardhësi që dje ka përfunduar afati i ankesave dhe ne tash i kemi 3 kompani që do të operojnë në ndërtimin e rrugëve lokale ne qytetet dhe fshatra sipas prioriteteve ne komunën e Rahovecit, duke përfshirë edhe fshatin Ratkoc, nuk e di saktësisht numrin rrugëve por e di se është një kontratë e mirë dhe një kontratë e madhe që 3 operatore kanë me punua edhe pse jemi vonua nuk është varur nga ne sepse ka pasur vonesa edhe ne OSHP, ju e dini se kemi pasur shkurtime buxhetore dhe tash granti i performancës na ka mundësuar me qenë pak me stabil edhe në pikëpamje buxhetore kështu që tash do të kemi aktivitete ne terrene edhe menjëherë si të ndalen reshjet do të fillohet me punë.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, te nderuar anëtarë të kuvendit komunal. Do të ndalem tek pyetja e parashtruar nga Rexhep Oruqi pasi edhe jemi bashkë në komisionin e stacionit të autobusëve. Sa për informata ne si drejtori e Shërbimeve Publike i kemi 3 objekte të përkohshme që i mbledhim inkasimin nga stacioni i autobusëve dhe baca Rexhë po kërkon që për seancën e radhës që për 3 objektet e përkohshme të merret një vendim që të mos inkasohen mjetet. Drejtorja e shërbimeve publike e kishte bartur me një vendim për stacionin e autobusëve si të hyrë për shkak se të hyrat e stacionit të autobusëve janë shumë të vogla dhe e pamundësojnë funksionimin normal të tyre. Sa i përket administratës tatimore janë borgj afër 100,000 euro, me herët ata nuk kanë mundur me shfrytëzua ligjin për faljen e borgjeve mirëpo unë kam rae në kontakt dhe do të shkoj edhe me komisionin bashkarisht në ATK dhe do të kërkojmë që se paku të bëhet një marrëveshje në bashkëpunim me komunën sepse nëse hapet llogaria nga stacioni i autobusëve krejt të hyrat që i merr ne llogari i bllokohet edhe i merr ATK-ja. Sa i përket pyetjeve tjera besoj që i ka sqarua kryetari, sa i përket rrugës Fortesë- Krushë e Madhe është shumë e vërtet se kemi premtuar që do të bëhet mirëpo krejt është mungesa e buxhetit. Ne me fondin rezerve i kemi ndaje 25,000 euro d.m.th. është e pamjaftueshme por operatori që ka për detyrë asfaltimin e asaj rruge po besoj që do të përgjigjet sivjet dhe do ta trajton atë rrugë e sidomos ato pjesë që shumë të demoluara.

Fehmi Hoxha – Rreth përgjigjes që më dha kryetari për klubin e Basketbollit që tani nuk është prezentë por është nënkryetari unë do ta themë dhe do të evidentohet në procesverbal dhe duhet të jemi të qartë se çdo cent që është dhënë nga buxheti i kuvendit komunal OJQ-ve dhe ndihmave tjera që janë dhënë, unë kërkoj publikisht dhe zyrtarisht si anëtarë i kuvendit komunal që ekzekutivi të angazhojë një auditim ose grup auditorësh të pavarur për të audituar çdo cent që është dhënë, edhe pse me ligj është përcaktuar që mbi 10,000 kush merr, duhet që të bëjë auditimin vetë mirëpo në këtë rast kemi klubet që kanë marrë edhe më shumë se 10,000 euro edhe kërkoj zyrtarisht të auditohet çdo cent dhe jo vetëm ata por të gjithë ata që kanë marr mbi 1000 euro. Pra të sqarohet e gjitha edhe pse kryetari e dha një përgjigje që kemi dyshime sa i përket llogari dhënies, kështu që nëse ka hapësirë për dyshime atëherë ke për obligim duhet me patjetër me angazhua edhe auditorët e jashtëm dhe duhet të dihet se ku kanë shkuar dhe si janë shpenzuar çdo cent. Pastaj vitin e kaluar i ka ndihmuar me 40,000 euro që është për lëvdatë kurse sivjet ka ndarë 50% më pak dhe kjo nuk është mirë dhe nuk është e rastësishme që mora paralelen e klubit të Futbollit “Rahoveci” i cili prej Superligës ka rënë në rangun me të ulët. Po ashtu i thash që të ndikoj si autoritet te donatorët e mundshëm aktual dhe të tjerët për të mirën e gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit. Po ashtu dua të potencoj se është në fuqi rregullorja për ndarjen e subvencioneve, ku deri 1000 euro i jepen individit nga ana e kryetarit kurse deri ne 2000 organizatave joqeveritare, a është shfuqizuar kjo rregullore apo ekziston me ligj diçka tjetër dhe nëse ekziston me ligj dhe është e ndarë atëherë ne duhet të shfuqizojmë rregulloren aktuale e cila është në fuqi. Pra, edhe njëherë po e potencoj pasi erdhët tani, kërkoj si kuvendarë që kryetari i komunës të angazhojë auditor të jashtëm të pavarur dhe të auditohet çdo centë i cili është dhënë organizatave joqeveritare mbi 1000 euro, edhe pse klubet apo OJQ-të që marrin mbi 10,000 euro kanë për obligim ligjor që ata ta bëjnë auditimin e jashtëm mirëpo nëse nuk kanë bërë atëherë unë kërkoj që për çdo centë të japin llogari pasi nuk është kjo që po e dimë që ka diçka dhe nuk po e audiojmë atëherë është shumë keq edhe për kryetarin edhe për gjithë neve, pasi janë para të komunës. E thash që 40,000 euro keni

ndarë vitin e kaluar dhe nuk e di se si i keni ndaje në bazë së cilës rregullore pasi që në bazë të rregullores mos kemi bërë shkelje apo vepër penale, rregullorja është ekzistuese atëherë ta shfuqizojmë nëse është diçka e rregulluar me ligj mirëpo sivjet 50% me pak dhe kjo nuk është për tu lavdëruar.

Kryetari – Është e vërtetë që OJQ-të ne kemi për detyrë me i mbështetë edhe i japim vetit detyrë sepse ka një fond nga subvencionet e kulturës, rinisë dhe sportit apo edhe kategori tjera që nëse kanë plane të mira të aktiviteteve tyre ne i mbështesim rregullisht dhe komuna jonë vazhdimisht i ka mbështetë. Në këtë rast ka pasur një diskrepancë të madhe të shumës që e ka marrë Klubi i Basketbollit dhe klubet tjera. Arsyeja është e thjeshtë sepse sukseset e klubit na kanë dhënë plotë argumente dhe ne kemi luftuar shume për ata edhe luftojmë, e thash porosit mbetet e njëjtë mirëpo sivjet jemi në gjendje të pandemisë ku aktivitetet artistike kulturore sportive përveç këtyre virtuale nuk ka pasur dhe ju këtë po e shihni edhe vetë. Unë jam dakord që në parim por edhe ne praktike me pas auditim, por veç po ju siguroj që më është dashtë me ndërhyje vitin e kaluar në një situatë që Klubi Bashkimi në Prizren ka krijuar obligime në ATK në shuma të mëdha mbi 300,000 euro për shkak të mos llogaridhënies mirëpo neve na përgjigjen për shkak se janë të obliguar me kontratë me sjellë një raporte. Por sido qoftë unë jam për auditim të secilës veprimtari apo individë ku përfiton prej shtetit e ne këtë rast prej komunës e madje jam edhe për auditimin e stacionit të autobusëve sepse ne nuk jemi entuziast apo krenar se dikush shkon në burg, pasi kush i krijoj ato obligime pse u krijuan ato obligime a mos u futen para ne xhep prej atyre që kanë qenë dikur apo diçka e ngjashme të kësaj natyre, unë s'jam as hetues e as prokuror por sidoqoftë auditimi i stacionit të autobusëve duhet me ndodhë pasi është barrë edhe i kuvendit të komunës pasi ka themeluar diçka e ka marr këtë ndërmarrje edhe me vendim të kuvendit pasi ka krijuar një bord edhe unë e di brengën e këtyre sepse tash këta paguajnë obligime dhe ato obligime se kush i ka shkaktuar auditorët munden me na tregua. Pra, jam për auditimin edhe të ndërmarrjeve publike Ekoregjonit edhe të plotë ndërmarrjeve si KRU-Gjakova segmenti Rahovec, pra auditimi duhet me ndodhë se kemi vështirësi me ndërmarrje publike pastaj me ish ndërmarrjen publike, po ashtu harrova me potencua se 120,000 euro është vlera e shpronësimit të rruga të fabrika e plastikes apo 18 Nëntori dhe ata nuk po pajtohen me këtë shumë dhe lënda përsëri është në procedurë gjyqësore. Kështu që ndoshta dikujt i shkon ne mendje me marr shumë të madhe të parave mirëpo sigurisht se ata nuk pajtohen për shkak se janë të licencuar për vlerësimin dhe e din sa është çmimi i tregut. Pra këto pakënaqësi që krijohen edhe me të drejtë që janë shqetësime që u ngritën ne kuvend, edhe klubi i basketbollit ka hy ne obligime pasi sigurisht se duhet me ble lojtar dhe donatorët kanë fillua me ju largua për shkak edhe të gjendjes se krijuar nga pandemia, problemet që po kanë bizneset janë probleme reale dhe ju e dini sa kemi humbje nga pandemia në komunën tonë që sipas llogaritjeve pasi kemi raport nga një kompani e licencuar që deri në fund të vitit nëse vazhdon ky trend llogaritjet që humbjet në sektorët e komunës së Rahovecit janë mbi 54 milion që realisht që humbjet janë edhe të bizneset. Kështu që unë nuk mundem me nda tash 40,000 euro sivjet edhe për shkak të pandemisë edhe për shkak të kërkesave në rritje që i kanë të gjitha OJQ-të e tjera edhe për shkak se nuk ka aktivitete. Tash kanë fillua aktivitetet dhe ne do të bëjmë lobim që klubi me u rikthye fuqishëm në skenë nëse fillojnë aktivitetet sportive por nuk mundemi me i ndaje 40,000 euro për shkak se sivjet kaq ishin mundësitë dhe kjo nuk do të thotë që vitin e ardhshëm nuk do të marrin 40,000 apo më shumë sepse mund të hiqemi nga pandemia dhe mund të kemi një situatë krejt më normale dhe mund të kemi situata që neve na japin mundësi me i ndihmua edhe më fuqishëm klubit, mirëpo udhëheqja e klubit të basketbollit po kërkojnë dhe ne do të nënshkruajmë kontratën nesër, mirëpo arsyeja pse këtë vit nuk kemi mundësi me ju dhanë atë shumë është se vitin e kaluar është mbajtur kampionati dhe ju e dini se na e shkelim edhe rregulloren e kuvendit për ti ndihmuar klubit të basketbollit Rahoveci. Pra ne e shkelim rregulloren për sa i takon mënyrës se si mirëmbahet palestra dhe ju e dini mirë se cila është ajo rregullore dhe po ashtu ju e dini mirë se 20% e biletave i takon si e hyrë kuvendit të komunës dhe ju e dini mirë se mirëmbajtjen edhe krejt furnizimet tjera i bën komuna e Rahovecit dhe po ashtu kemi bërë shmangie nga rregullorja për me i dhanë fuqi klubit të basketbollit dhe tash krejt këto merita dhe përkrahje e juaja dhe ne

emër tuajin nuk duhet me u keqinterpretua për shkak se nuk mund t'i ndihmojmë askujt se nuk kemi mundësi më shumë se 22,000 euro dhe tash edhe jemi në fund të vitit edhe nuk do të kemi mundësi me nda ndonjë shumë qoftë edhe urgjente. Porosia e qartë është se klubi ka me u mbështet fuqishëm do të ishte mirë me ndërrua strategjia sikur në komuna tjera dhe mos me llogarit që veç prej komunës me u mbështet klubet sportive edhe shoqëritë kulturore artistike, sigurisht që mbështetja do të jepet sipas mundësive buxhetore por me gjete alternativa tjera siç kanë gjetur edhe nëpër komuna tjera. Unë ju tregoj se komuna e Suharekës nuk e jep asnjë cent për klubin e Basketbollit sepse u privatizua klubi prandaj edhe inkurajoj që me ndërrua edhe statusi i Klubit që mu kthye në shoqëri aksionare por deri sa të bëhet ajo ne do të bëjmë përpjekje që me mbështet fuqishëm si komunë. Edhe unë po zotohem publikisht edhe ne emër të tuajin se ka me mbështet fuqishëm por sivjet kaq ish-in mundësitë buxhetore kurse sa i takon auditimit do të ishte mirë me ju bo auditim gjithë atyre përfituesve.

Vahid Krasniqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar kolegë asamblistë. Unë realisht nuk kisha pyetje kryetar mirëpo pasi që u lidh çështja e komisionit e ndjej veten të obliguar të flas pasi edhe jam pjesë e komisionit. Unë kam dhënë një propozim të kryetarja e komisionit por edhe tek drejtori që është ekzekutiv. Nuk mundemi me propozua emra të emërtimeve të rrugëve të reja prej zyrës por duhet me dal në terren. Ju duhet të caktoni orarin nëpër fshatra, pastaj i kam parë emrat rezervë që nuk kam asgjë personalisht kundër atyre emrave por ata emra ka fshatra që nuk i pranojnë p.sh. dy rrugë në fshatin Drenoc që nuk i pranojnë pasi i kanë emrat e vet dhe unë i kam kërkuar edhe drejtorit edhe kryetarit të komisionit me gjete një normë ligjore ose me eliminua listën ose me shtua emrat që i propozon fshati ose lagjja. Këtë e kam kërkuar dhe nuk e di tash kryetarja e komisionit çka ka bërë në këtë drejtim por kjo ishte kërkesa ime.

Kryetari – Pajtohem me ju se komisioni duhet me dal ne terrenë, se ka një pengesë ligjore e duhet ndoshta kuvendi me rivendos çështjen edhe njëherë edhe me diskutua por sidoqoftë është temë e ndjeshme dhe unë nuk kam dëshirë me u përfshije direkt pasi kemi një ligje që na tregon rrugën se si duhet me ardh deri te nominimet apo emërtimet por unë e inkurajoj komisionin në krye me drejtorin e urbanizmit që të mblidhen dhe të shohin në përpikëri të gjitha. Vërtet është shumë vështirë pasi është çështje e ndjeshme pasi dikush edhe e ka emërua të parit të vet e shumë pakënaqësi tjera dhe këto pakënaqësi janë të pranishme në gjithë Kosovën. Se çfarë epilogu do të merr kjo, një komision e ka themelua kuvendi dhe unë e kisha lutë komisionin që me bo punën e vet qoftë ne zyre apo ne terrene dhe ju siguroj që mëditjet do të jepen, sigurisht që mbështetja do jepet edhe për punën ne terrene që me zhvillua debate por sigurisht që duhet të sjellët një raport kryetarit të komunës e pastaj kryetari i komunës me ekip e propozon kuvendit të komunës. Pra kjo është rruga po besoj por pakënaqësi gjithmonë do të ketë por ne duhet të vazhdojmë të kryejmë punë pra me i krye sivjet disa pune edhe komisioni për emërtimin e rrugëve shesheve rrugicave etj.

Ali Zhuniqi – Në lidhje me përgjigjen e kryetarit ku në njërin pjesë nuk me jeni përgjigjur që sigurisht ja keni lënë atë pjesë drejtorit por tek çështja e subvencioneve kur e dhatë sqarimin ju thatë që nuk e besoj kështu që nuk jeni të sigurt për përgjigjen që keni dhënë ose e dini e nuk dëshironi të komentoni rregulloren për subvencion e që sigurisht as unë nuk e di dhe kërkoja sqarim lidhur me këtë çështje. A ka të drejtë me marr studentet të cilët studiojnë jashtë vendit me rregullore me subvencione a po nuk kanë të drejtë, pasi në parim edhe unë jam për me i mbështet studentet pavarësisht se cilit universitet studiojnë bile edhe jemi për me rritë numrin e bursave normalisht duke respektuar kriteret ne bazë të cilit shpallen DKA-ja. Ajo rregullore është e specifikuar pasi kur është bërë publikimi të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentet janë pjesë e universiteteve publike por jo edhe jashtë universitetit. Pra në konkurs në parim i bie se ju e keni shkelur atë edhe ne këtë desha të ndërlidhem e sigurisht ju e dini ndërsa për çështjen e konkursit e ftojë drejtorin e arsimit me na dhanë përgjigje pasi për këtë pjesë nuk fole asgjë ose ja ke lanë drejtorit të arsimit.

Kryetari – Besoj që kuvendi i komunës e din edhe sigurisht që anëtarët më të vjetër e din se kryetari e ka të drejtën që deri në shumen 1000 euro që pa pyetur asnjërin drejtor me marr vendim për një subvencion të caktuar që me subvencionua dikën, pasi e ka të rregulluar edhe me rregullore të kuvendit të komunës bile

unë kam kërkuar që deri në shumën 5000 euro me pas të drejtë, por rregullorja ishte për 2000 kurse tani është zvogëluar në 1000 euro. Për më shumë se 1000 euro nuk ka të drejtë me marr kështu që e dërgon në Kuvend për subvencion ose duhet përmes thirrjes pra është fjala për individ. Tash besoj se jemi të qartë rreth kësaj çështje. Dhe unë nuk e kam shkelur konkursin por vetëm kam dhënë porosi që edhe studentet që studiojnë jashtë vendit me i inkurajua dhe me i ndihmua me një shume të caktuar, pra thjesht ky ishte parimi. Po të ishte ndeshë me rregulloren atëherë me siguri ma të madhen unë e marr të drejtën dhe përgjegjësin vet edhe me vendim të kryetarit, me te vetmin qellim se është studentë që ka aplikuar dhe i plotëson kushtet e konkursit. Pra ideja ishte që me ju dhanë mundësi edhe atyre të rinjë, që sigurisht që mundohem që me ju ndihmua qoftë edhe për biletë të autobusit apo biletë të aeroplanit për ndonjë talent që shkon jashtë të muzikës, arsimit që tri vite kam dhënë e po ashtu edhe ish kryetari ka dhënë. Unë mendoj që seancën tjetër ju vete e thate që na sjell një informatë prandaj edhe mendoj se muajin tjetër drejtori i arsimit ta jep një informatë specifikisht juve apo e paraqet në kuvend.

Avni Morina – Përsëritet për të gjithë, përgjigja është shumë e shkurtër dhe nuk e di se Ali Zhuniqi a e ka lexua ligjin e punës ku aty shume thotë se punëtori paralajmërohet për humbjen e vendit të punës nëse është kontratë të përhershme. Dhe punëtori në fjalë për të cilin po shqetësoji ju ka qenë me kontratë të përkohshme dhe ai ka qenë i vetëdijshëm për këtë prandaj është bërë pjesë e konkursit, ka hyrë në procedurë të konkursit dhe ju ka nënshtruar testit me shkrim testit me gojë dhe unë nuk kam faj që nuk ka dalë i pari, edhe keni ngatërrua totalisht emrin e saj se është Drenusha Jupa e jo Selmancena. Ajo ka kontratë të përkohshme, zëvendësim pushimi lehonie deri sa të kthehet prej pushimit të lehonisë ndërsa personi për të cilin shqetësohesh ti e ka pasur kontratën me datën e fillimit dhe të mbarimit, edhe me shantazhe nuk zgjidhen problemet por ju është mirë me u shqetësua që kolegu juaj ka bërë shantazh inspektorëve të arsimit edhe kanë qëndruar 4 ore në stacionin e policisë në Gjakovë. E sa i përket bursave unë jam me i dëmtuari edhe nuk i kam lan me aplikua.

Kryetari – E para në rast të udhëheqjes së seancës, unë do ta kisha nxjerr jashtë mbledhjes së kuvendit asambleist z. Ali Zhuniqi për fyerje, e dyta nuk është strumbullar i Komunës së Rahovecit tani dhe le të bëhet sigurisht se do ta respektojmë dhe e treta une nuk lejoj të ma fyejnë drejtorin dhe sigurisht asnjërin nga ju dhe jam në gjendje të përballem edhe fizikisht ai që merret me këto punë. Dhe nga ky moment i sugjeroj drejtorit Avni Morina që mos me ju përgjigj në asnjë lloj pyetje të asambleistit Ali Zhuniqi dhe këtë nuk e ka obligim ligjor dhe për të gjitha pyetjet e drejtuar për drejtorin, do të përgjigjem unë në çdo kohë mirëpo drejtori Avni Morina nuk do të përgjigjet në asnjë pyetje që ju drejtoni deri në fund të mandatit.

Rukije Krasniqi – Tek çështja e emërimit të rrugëve dhe shesheve nga mandati i kaluar ka pasur lëshime rreth këtij pozicioni sepse nuk janë respektuar kriteret rreth këtij emërimi. Për me emërtua rrugë, sheshe dhe institucione duhet se paku të jepet një biografi për çdo propozues kush dhe çka ka kontribuar dhe e vetmja në këtë kuvend nga mandati i kaluar jam unë që kam dhënë një biografi për Malush Shiqeri Duraku, një kontribuues i çështjes kombëtare që nga viti 1947 i vili ka punuar ilegalisht dhe një mësimdhënës që në vitin 1951 kur nga forcat serbe të ish Jugosllavisë është burgosur në Goliotok 6 vite, në Nish 3 vite dhe Prizren dhe nga gjithë ky kontribut i një njeri të shquar të çështjes kombëtare që lidhet në dy shtetet tona në Shqipëri dhe Kosovë, që do të thotë se fshatin tij të lindjes nuk është gjetur mundësia e emërimit as edhe të rrugës se vetme që ekziston në fshat, jo vetëm që e ka merituar të një institucioni por edhe as edhe një rrugë të vetme pasi janë emërtua njerëz që në luftë nuk do të thotë që kanë vdekur aksidentalisht por ndoshta edhe që kanë qenë edhe kundër luftës pasi nuk dua të futem edhe me tutje për shkak të ndjeshmërisë së çështjes por kriteret nuk janë përfill fare. Dy rrugë janë emërtua me të njëjtin emër dhe nuk është gjetur mundësia e arsyeshmërisë nga ky njëri kontributdhënës i çështjes kombëtare për asnjë moment të vogël.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, tani kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2021.

Afrim Limani – I nderuar nënkryetar, të nderuar ju asamblastë dhe gjithë ju të pranishëm. Para se me fillua diskutimin e buxhetit paraprakisht, unë desha me i diskutua edhe dy çështje që konsideroj që janë shumë të rëndësishme. E para ka të bëjë se dallimi ndërmjet qarkores se dytë dhe të tretë ka ndryshime, ku në adresë tonë të Komunës së Rahovecit na ka ardh qarkorja e tretë buxhetore e që realisht kjo nuk ka ndodhur asnjëherë mirëpo për shkak të situatës së krijuar nga pandemia në adresën e komunës tonë ka ardhur qarkorja e tretë buxhetore sikur në çdo komunë tjetër të Republikës së Kosovës dhe qarkorja e tretë buxhetore ka rezultuar me një shkurtim të buxhetit në vlerë prej 333,000 euro në total, ku 233,000 i kemi zvogëlim në grandin e përgjithshëm ndërsa 95,748 euro në të hyra vetanake dhe e gjithë kjo ka shkua në dëme të investimeve kapitale të cilët në qarkoren e dytë sipas limiteve ka qenë 4,619,000 ndërsa tani e kemi zvogëlimin të investimet kapitale me 4,286,000 dhe zvogëlimi i buxhetit në 14,216,590 euro e që realisht ishte 14,548,000 euro. Gjithashtu kemi edhe zvogëlim edhe në të hyra vetanake dhe me takon të ju informoj të nderuar asamblastë sepse kemi një shkurtim prej 95,748 euro e që realisht na ka prishe edhe balancet tona në planifikimin e të hyrave vetanake e që jemi detyruar të bëjmë shkurtime të mëdha në kategori ekonomike të cilat edhe dalim nga pozita e planifikimit real që duhet me qenë. Ne edhe para qarkores se dytë buxhetore kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Financave e konkretisht në departamentin e buxhetit që të hyrat vetanake të rriten më tepër se sa janë pasi jemi të sigurt se ato mund të i inkasojmë që një gjë e tillë edhe ka ndodhur, pasi ju e dini vitin e kaluar kemi pasur një tepricë të hyrave vetanake dhe ata le që nuk bënë zvogëlimin por tash na kanë zvogëluar prapë me qarkoren e tretë buxhetore dhe çdo planifikim i të hyrave vetanake në kode ekonomike nuk është një planifikim real edhe që jemi detyruar ta bëjmë. Si çështje e dytë që ndoshta nga ju e dini por ka edhe që nuk e din se komuna e Rahovecit ka përfutua një grandë të performancës me vlerë prej 655,000 euro dhe jemi shpallë komuna e dytë në nivele të Kosovës edhe kemi pasur rekomandime se kjo vlerë e këtij buxheti të futet në kuadër të planifikimit të vitit 2021 mirëpo deri me ditën e sotme nuk ka ndodhur kjo, kështu që ne duhet me veprua me një mënyrë tjetër. Këto projekte kapitale ne duhet ti lemë me vlerë zero në mënyrë që mos të dalim jashtë ligjit dhe jashtë limiteve të caktuara buxhetore që eventualisht ka hapësirë kohore pa u mbyllë viti fiskal dhe atëherë këto mjete ne mund të i derdhim në kuadër të këtyre projekteve kapitale. Të pjesa e investimeve kapitale të ju informoj se çdo kërkesë e qytetarit është e përfshirë në kuadër të investimeve kapitale, në bazë të dëgjimeve buxhetore që i kemi bërë përmes KPF-së unë konsideroj që çdo kërkesë e qytetareve është e futur në planifikimet buxhetore të vitit 2021 si dhe projeksionet e vitit 2021-2023, po ashtu janë edhe disa projekte të reja që kanë dalë në bazë të kërkesave të qytetareve dhe ju mund ta shihni në kuadër të kësaj liste. Listën e investimeve kapitale ju mund ta shini edhe në projektor e po ashtu i keni edhe në materialin që keni pata vetes dhe nuk po e shoh të arsyeshme me lexua rend tani pasi ju veç e shihni në monitor edhe mund të jepni sqarimet e juaja.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, fillimisht shfrytëzoj me ja urua drejtorit të Financave për grantin e performancës dhe është mirë që ka ndodhë kjo sepse vërtet është një shumë e mirë për buxhetin e komunës tonë për shërbime ndaj qytetareve tanë, kështu që urime drejtor dhe gjithë atyre që kanë kontribuar. Ne e kemi analizuar dhe e kemi shqyrtuar edhe në mbledhje të Komitetit për Politike dhe Financa propozim buxhetin për vitin 2021 dhe i kemi pasur disa shqetësime tonat edhe i falënderoj drejtorët që disa çështje i kishin përmirësuar d.m.th. i kanë largua ato që ka pas nevojë dhe ajo që dua të them është se në këtë propozim buxhet, ne si Komitet për Politikë dhe Financa e dini se kemi mbajtur disa dëgjime buxhetore dhe kemi marr mendime prej qytetareve dhe themi të drejtën shumica e atyre mendimeve janë të futura në këtë propozim buxhet dhe neve na mbetet tash vetëm të diskutojmë edhe disa gjëra tjera që ka pas nevojë dhe secili i jep mendimet e veta. Desha t'i them drejtorit se në mbledhje të Komitetit për Politike dhe Financa i kemi pas në disa kode buxhetore disa shumë tjera që kanë qenë më të mëdha kurse tash si grup i PDK-së e pamë e se ka zvogëlime në disa kode dhe me siguri që drejtori do të na jep përgjigje për këtë se pse ka ndodhë. Pastaj ne kemi konstatua se gjithashtu në disa kode ka keq klasifikime pasi edhe vitin e kaluar e

kemi diskutuar këtë çështje mjaftë por është për të ardhur keq që edhe qeverinë edhe neve kuvendarëve na kanë lanë keq në këtë drejtim pasi është deshtë me i dhanë të drejtë njëres palë apo tjetres palë por prapë nuk kanë diskutuar për këtë punë por unë po e ngris si çështje pasi në 4-5 kode janë afër 500,000 euro dhe janë futur në investime kapitale e ne fakt për neve janë subvencione dhe shërbime. Sa me i përmend disa si Hartimi i projekteve të ndryshme vazhdim që realisht është shërbim dhe nuk është kapital, pastaj kemi kodin 46674 Ndërtimi i serrave me participim edhe ky është subvencion, pastaj kodi 47832 Përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizëm bujqësore edhe ky është subvencion, pastaj kodi 47865 Stalla dhe ferma të vogla për fermerë që gjithashtu është subvencion. Por për këtë unë do të thoja se për çdo rregullore që e miratojmë si kuvendë apo çdo gjë tjetër që ka këtu, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për një shkronjë na kthen mbrapa dhe mendoj se kjo nuk është përgjegjësi e kuvendit tash ne të merremi mes vete dhe ata janë duke e përcjellë këtë transmetim dhe sigurisht që duhet të japin mendimin e vet dhe ne të vazhdojmë tutje, pra janë kompetent me dhanë fjalën e tyre edhe MAPL-ja edhe Ministria e Financave në këtë rast e po ashtu edhe auditorin e kemi pas për vitin e kaluar. Po ashtu një kod që ka pasur mjete të ndara kurse tash nuk ka edhe është zero pra kodi 40838 që kanë qenë të parapara 30,000 euro kurse tash nuk ka asnjë vlerë, emri i projektit është mbikëqyrja e punimeve vazhdim. Pastaj tjetër që kemi konstatua ne është se kemi kode të përgjithësuara, ku ne Komitetin për Politike dhe Financa kemi thënë se ka kode shumë të përgjithësuara dhe kemi kërkuar që ato të jenë të detajuara ose të specifikuara me mirë në mënyrë që ne drejtpërdrejtë por edhe qytetaret ta dinë saktësisht se në cilin vend dhe cili projekt do të realizohet në vitin 2021, por edhe këtu kemi marr përgjigje pasi drejtori i Shërbimeve Publike na ka dërguar neve shfaqje të grupeve njëfarë liste ku tregohet për disa kode faktikisht se në cilin vend ku do të punohet pastaj sa metra rrugë apo kanalizim kështu që e falënderoj drejtorin që na ka dhënë këtë shënim që ne me qenë me të qartë sa i përket se ku do të investohet. Unë përveç këtyre që i thash, kemi edhe diçka si grup i PDK-së dega në Rahovec, ku mendojmë se duhet me hap kod të ri por është një kod ekzistues ku janë ndarë një shumë prej 70,000 euro pra fjala është për Ndërtimin dhe trajtimin e ujërave atmosferikë në qytetin e Rahovecit kryesisht në rrugën Selajdin Mullaabazi, Xhelal Hajda dhe Fahredin Hoxha, ku aty janë të parapara mjetet dhe po ashtu kodi ekziston apo ndoshta mundemi me hap edhe kod të ri, por ne propozojmë si grup që të shtohet shuma për shkak se nuk mjafton që me ato mjete me u krye ajo, po ashtu në KAB e keni paraparë që për vitin 2021 me i shtua edhe 100,000 euro mirëpo ne për vitin 2021 propozojmë që për këtë projekt për kodin 49877 Trajtimi i ujërave atmosferik në qytetin e Rahovecit kryesisht në rrugën Selajdin Mullaabazi, Xhelal Hajda dhe Fahredin Hoxha të shtohet shuma dhe të jetë 200,000 për vitin që jemi e po ashtu edhe në KAB është e paraparë që me vazhdua e po ashtu edhe shuma për vitin 2022 duhet të shtohet pasi aty është vetëm 100,000 euro mirëpo ju me siguri do ta keni parasysh se kur ta nisni duhet me patjetër edhe me përfundua. Po ashtu një kod tjetër me hap është për ndërtimin e stadiumit të qytetit tek Epopeja e UÇK-së, edhe aty mendojmë që do të ishte mirë me nda një shumë prej 100,000 euro, në mënyrë që të fillohen punimet rreth asaj që me siguri edhe keni planifikime por këtu nuk e kemi parë që ekziston. Edhe kërkesa e tretë e grupit të PDK-së është Ndërtimi i rrethojës së oborrit të shkollës fillore në Çifllak. Këto janë kërkesat tona përveç buxhetit që është ekzistues që e keni paraparë ju edhe grupi i PDK-së në Kuvendin Komunal të Rahovecit do ta voton buxhetin me këto kushte të cilat i ceka tani.

Florida Bajraktari – Unë desha me cekë se këtij propozim buxheti për vitin 2021 i mungon buxhetimi i përgjegjshëm gjinor. Qëllimi buxhetimit gjinor është për të reduktuar pabarazinë gjinore dhe përmirësimin e mirëqenies së grave dhe gjithë qytetareve të komunës së Rahovecit përmes buxhetit komunal. Buxhetimi gjinorë për komunën tonë ende mbetet një sfidë dhe shpresoj që vitin e ardhshëm kjo sfidë të tejkalohet.

Ali Morina – Ky është buxheti që është paraqitur nga drejtori dhe kërkesat e qytetareve i kemi parë e po ashtu kemi pasur rastin me i pa edhe në procesverbalet e dëgjimeve publike që janë mbajtur nga KPF-ja dhe pothuajse të gjitha kërkesat janë të njëjta dhe po pajtohem me z. Fazliu që tha se disa çështjeve nuk ju ka dhënë përgjigje organet tjera dhe auditori gjeneral ka mundur me dhanë një përgjigje më të mirë, që me gjet

si shkelje apo me thanë që është mirë por përderisa nuk e ka dhënë një opinion tjetër konsiderojmë se ajo është një klasifikim i duhur. Në parim si grup i AAK-së i japim mbështetje të plotë këtij projekt buxheti mirëpo e kisha një vërejtje pasi neve nga drejtoria e shërbimeve publike na është paraqitur lista e investimeve kapitale se ku do të kryhen dhe ajo që e kemi parë është se janë disa vendbanime që nuk janë përfshijë por urojë që të përfshihen me grandin e performances, ku njëri ndër ta është edhe fshati Guri i Kuq që nuk e kam pa në asnjë projekte dhe uroj që të përfshihet në kuadër të këtij projekti pasi ata kanë kërkesa për dy rrugë dhe nuk janë rrugë të mëdha pra njëra është 150 metra afërsisht kurse tjetra 400 metra, pra urojë që këto kërkesa të merren parasysh dhe të realizohen këto projekte. Ne i japim mbështetje të plotë këtij projekt buxheti.

Masar Popaj – Unë desha të flas për planifikimin e të hyrave vetanake për vitin 2021-2023 për buxhet dhe financa tek tatimi në pronë të planifikuara të hyra vetanake për vitin 2020 janë të parapara 390,333 euro kurse për vitin 2021 janë të parapara 619,394 euro. Atëherë pse është kjo diferencë kaq e madhe ku diferenca është 229,061 euro, po ashtu tek tatimi në tokë janë paraparë për vitin 2020 janë të planifikuara 150,840 euro kurse për vitet në vijim nuk ka të planifikuara, pastaj tek administrata dhe personeli si taksa dhe certifikata të lindjes të planifikuara për vitin 2020 janë 72,500 euro kurse për vitin 2021 janë 14,500, pra është një diferencë shumë e madhe dhe dua të di arsyen pse është kjo diferencë kaq e madhe të të hyrave të planifikuara për vitin 2021, pastaj tek taksat dhe certifikatat e tjera ofiqarë të planifikuara për vitin 2020 janë 1168 euro kurse për vitin 2021 janë të planifikuara 18,000 euro që realisht është një diferencë prej 16,832 euro. Po ashtu tek shërbimet publike të hyrat nga shitja e mbeturinave të parapara janë të parapara 32,000 për vitin 2020 kurse në vitet në vijim nuk ka të planifikuara, tek shfrytëzimi i pronës publike të planifikuara janë 12,000 për vitin 2020 kurse për vitin 2021 janë 6447 euro që realisht ka një rënie prej 5553 euro me pak. Po ashtu te Bujqësia dhe zhvillimi rural, në vitin 2020 janë të parapara 52,000, pastaj në vitin 2021 janë parapare 53,000 kurse për vitin 2022 janë parapare 90,000 që ne krahasim me vitin 2021 janë 37,000 e që vijon për në vitin 2023 janë 97,000 që ka një diferencë prej 42,000 dhe dua të di arsyen pse. Pastaj Ekonomia dhe zhvillimi, taksa për zhvillimin e veprimtarisë të parapara për vitin 2020 janë 87,500, kurse për vitin 2021 janë të parapara 58,000 që është një diferencë prej 29,500 me pak. Po ashtu tek qiraja dhe vendosja objektit tregtar, për vitin 2020 janë 75,000 kurse për vitin 2021 janë 23,252 euro që i bien me pak prej 51,748 euro dhe dua të një sqarim tek qiraja dhe vendosja e objektit tregtar se a është objekteve tregtare apo objektit apo është ndonjë gabim teknik pasi me sa e di unë tek të hyrat për vitin 2021 vetëm në Matrex parashihen me pas mbi 45,000 euro të hyre kurse këtu janë të parapara 23,252 euro. Pastaj kadastër dhe gjeodezi, taksa tjera administrative për vitin 2020 janë të parapara 25,000 kurse në vitet në vijim nuk ka asgjë të planifikuara, pastaj urbanizmi, taksa komunale për leje ndërtimi për vitin 2020 janë 17,700 kurse për vitin 2021 janë planifikuare 20,000 që është një diferencë prej 2300 euro, taksa për legalizimin e objekteve për vitin 2020 janë parapare 14,200 kurse për vitin 2021 janë planifikua 18,000 pastaj 2022 janë planifikua 37,000 kurse për vitin 2023 janë paraparë 40,000.

Fehmi Cena – Para se me kalua në diskutimin apo mendimin përfundimtar, në emër të grupit unë dua të kërkojë disa sqarime si delegatë për projektbuxhetin e vitit 2021 e konkretisht për KAB-in 2021-2023 dhe pikërisht tek planifikimi i investimeve kapitale. Pra janë disa kode që do të kërkojë sqarim, tek shërbimet publike është kodi 43468 ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Rahovec-Pataqan i poshtëm ku keni planifikua për 3 vitet e ardhshme investime në këtë rrugë dhe sa e di unë ndërtimi dhe asfaltimi i asaj rruge është kryer dhe nuk e kam të qartë se perse afër 500,000 euro i keni planifikua se a është në pyetje ndërtimet shitesë apo borxhi dhe nëse është njëra nga këto atëherë kërkesa jonë është që ky projekt të përshpejtohet dhe të kryhet nëse vërtetë kemi borxhe apo doni me ndërtua diçka ajo të kryhet brenda vitit 2021 sepse ky projekt edhe ashtu shumë po stërgjartet pasi ka filluar qysh në vitin 2017. Te bujqësia, është kodi i ri Ndërtimi i rrjeteve anti breshër për vreshta dhe pemishte, dhe unë kërkoj një sqarim si mendoni pasi është diçka e re që do të ndërtoni dhe a ka drejtë komuna, apo mendoni ju me ndërtua rrjeta edhe pastaj me ju dhanë bujqve apo

përmes formës së subvencionimit megjithëse këto janë investime kapitale? Gjithashtu në shëndetësi po i shoh dy kode që kemi nevojë për sqarime që të dyja janë kode të reja, si Ndërtimi, rregullimi dhe meremetimi i repartit të pediatriisë dhe stomatologjisë, edhe këtë nuk e kam të qartë pasi janë shuma të mëdha të parave të planifikuara. Tash veçse e kemi ndërtuar pra është QKMF-ja e re edhe aty sigurisht se ka vend edhe për stomatologji e pediatri e po ashtu është edhe objekti i vjetër dhe nëse është për renovim atëherë është krejt diçka tjetër por këtu shkruan ndërtimi. Gjithashtu edhe ndërtimi i një AMF-je në Lagjen e Epërme ceket dhe dua të di se për cilën lagje është fjala pasi nëse është për atë lagje që ne e njohim si Lagje e Epërme atëherë aty është ambulanca dhe është ndërtim i ri dhe mendoj se i plotëson kushtet për aq sa ofrohen shërbime dhe ka nevojë ajo pjesë e qytetit. Te kultura, rinia dhe sporti kodi 48201, restaurimi i objektit përkujtimor për 64 të masakruarit në Krushë të Madhe, dhe ne e kemi marr vendim për këtë shtëpi që të restaurohet mirëpo ju e keni paraparë edhe për dy vitet e ardhshme të bëhen investime, unë mendoj pse nuk bëhet e gjitha brenda vitit 2021, nuk ka arsye pse me stërgjatë këtë projekt edhe ashtu nuk është e kushtueshme, pasi për vitin 2022 keni paraparë 10,000 euro kurse për vitin 2021 keni planifikua 5,000euro, pra bëhen 15,000 euro dhe brenda vitit të ardhshëm duhet të kryhet kjo punë, pastaj kodi 49953 ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore në Rahovec, edhe këtu neve na është dhënë një sqarim i shkurtër në KPF mirëpo nuk e kemi të qartë sepse paraprakisht nëse do të ndërtohej një qendër rinore dhe kulturore ajo sigurisht se duhet me pas edhe një vendim prej Kuvendit Komunal, pasi a ka komuna vend të përshtatshëm komunal kur dihet se këto objekte kërkojnë edhe investime shtesë pasi do të ketë edhe punësime të punëtorëve të rinj aty dhe a ka buxhet, pra janë disa procedura që paraprakisht duhet të kryhen me ligje dhe pastaj të planifikohen, po ashtu të njëjtin mendim e kemi gjithashtu edhe për projektin e ri Ndërtimi i muzeut në Krushë të Madhe që keni paraparë shpenzime mirëpo edhe për këtë nuk ka vendim nga Kuvendi Komunal d.m.th. procedurat paraprake duhet të kryhen dhe pastaj të planifikohen shpenzimet, e që ligjërisht shpenzimet nuk planifikohen nëse projektet nuk janë paraprakisht aty. Tek arsimi gjithashtu e kemi një vërejtje pasi përmenden disa shkolla fillore mirëpo nuk përmendet Xërxa askund. Ne gjatë dëgjimeve publike kemi pasur kërkesë nga qytetarët dhe këshilli i fshatit se shkolla në Xërxe nuk i plotëson kushtet për punë normale edhe është shkollë e vjetër edhe sigurisht se ka nevojë aty për një shkollë të re, pasi ajo shkollë nuk ka pas kabinet të ri, as sallë për edukatë fizike dhe së paku është të parashihen këto dhe të parashihet ndërtimi i shkollës fillore në Xërxe brenda kornizës afatmesme, pra të mos jetë për vitin e ardhshëm pasi do të ishte ngarkesë për buxhetin e komunës por së paku brenda periudhës 3 vjeçare.

Kryetari – Faleminderit për diskutuesit e deritashëm, besoj që janë ide shumë të qëlluara për disa sqarime të cilat i kërkoj edhe i dha z. Rasim Fazliu por njëkohësisht edhe disa kërkesa edhe sqarime që i kërkoj z. Fehmi Cena si dy përgjegjësit e grupeve politike që përfaqësohen në Kuvend pra të PDK-së dhe LDK-së dhe njëkohësisht edhe përgjegjësi i grupi të Aleancës, sa për me kanalizua debatin, pra është e vërtete që ka pasë debate të shumta për keq klasifikime dhe ne ju kemi përmbajt maksimalisht këtyre pozicioneve diskutabile dhe kemi kërkuar shpjegime që mos mu rikthye edhe njëherë edhe auditori e ka vlerësua komunën e Rahovecit edhe ne kemi raportin për vitin 2019 që është publikuar dhe është diskutuar edhe ne kuvend dhe që është nder raportet me të mira në historinë e komunës së Rahovecit sa i takon auditimit të jashtëm. Unë besoj që kontratat duhet me vazhdua edhe përkrahja në ato pozicione në ato kode duhet me vazhdua dhe nëse dënohemi atëherë kuvendi i komunës nuk mbanë përgjegjësi as kolektive si institucion dhe nëse dënohet ndonjëherë atëherë dënohet kryetari i komunës edhe drejtori i Financave por nuk besoj që ka me u dënua me këtë legjislaturë që e kemi dhe nëse ndërrojnë situatat atëherë ndërrojmë edhe ne të gjithë. Pra besoj që ato kode është mirë të mbeten sepse përkrahja e fermerëve pastaj rrjetet anti-breshër pra do të bëhen me participim 80% me 20% edhe rrjetet anti-breshër edhe mekanizmi bujqësor serrat edhe pajisjet tjera ose elementet tjera të cilat përfshihen në kodet që kanë të bëjnë me bujqësinë edhe degët e saja me nën sektorët e saj si blegtoria pemëtaria etj. po ashtu ndodhë edhe me Ndërtimin e stallave dhe fermave të vogla do të jetë me participim 80% me 20% pra 20% përfituesi kurse 80% komuna. Unë besoj që ato

kode duhet të mbeten dhe nuk besoj që ka arsye të frikësohemi ose të mbesim peng se si do të na thonë të tjerët në këtë rast organet me kompetente. Pra unë besoj që gjithçka do të jetë mirë edhe do të marrim mendime pozitive për të vazhduar në punën tonë. Një çështje interesante ka ngritur edhe z. Rasim Fazliu, unë në pikën e dytë ju thash se kanali i ujërave atmosferik në qytet në kushte normale dhe nëse kemi kushte klimatike të mira, kemi kërkuar nga operatori me krye brenda dy muajve, po para nuk ka pasi i kemi vetëm 50,000 euro për sivjet por kontrata kushton 248,000 euro, praj jam për me t'i shtuar mjetet për këtë kod për shkak se edhe vitin e ardhshëm nuk e plotëson kontratën ndërkohë që operatori punon në kushte normale nëse kemi kohë mirë e kryen brenda këtij viti. Pra nuk mundemi me shtua atë shumë sa tha z. Rasim Fazliu por mundemi me shtua edhe me zvogëluar tepër shumë këtë kontratë që pagesa me u krye brenda vitit 2021. Po ashtu çështje tjetër që ngrii z. Rasim Fazliu, për stadiumin e qytetit tek Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra lokacioni është i gjetur dhe ne kemi një memorandum me ish ministrin e kulturës z. Kujtim Gashi i cili memorandum është në fuqi dhe ka marr obligime ministria Dumoshi edhe unë besoj që nëse nuk ishte në fazën e vlerësimit mund të jetë tash në fazën e tenderimit. Pra është projekt që totalisht financohet nga Qeveria e Kosovës dhe do të na bëj krenar pasi do të jetë një projekt tepër i mirë dhe një stadium i kategorisë së dytë ashtu siç është edhe në memorandum edhe projekti do të ekzekutohet në cilësi, pra është diçka që ne kërkojmë prej ministrisë që shpresojmë të mos ketë vonesa dhe të fillojë ekzekutimi i projektit për ndërtimin e stadiumit në pjesën ku është Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ku janë bërë të gjitha matjet dhe mbi atë bazë është bërë edhe projekti ideor dhe projekti kryesor. Për sa i takon rrethojës së shkollës fillore në Çifllak. Unë sot edhe njëherë e kam rikonsultuar drejtorin e asimit se çka është ky kod për rinovim të objekteve shkollore, rinovim të nyjave sanitare pra në përgjithësi riparimi i shkollave dhe jam siguruar se kontrata është kornize ku parashihet se edhe 30% me shtua në kuadër të asaj kontrate me shtua pozicione që i mungojnë por sidoqoftë jam edhe për me hap kod të ri por mundem me dhanë zotimin edhe në emër të drejtorit të arsimit se kjo punë ka me u krye sepse është diçka që është e mundur dhe nuk ka ndonjë shpenzim kapital të madhe financiar që mos me përballuar. Dhe ne kemi dy kontrata tash për rinovim të shkollave dhe Lot-i i dytë ka filluar aktivitetin dhe është nënshkruar kontrata kurse Lot-i i parë ka fillua më herët. Unë besoj që shkolla e Çifllakut do të jetë në prioritet se edhe ashtu është objekt i vjetër dhe do të kryhet. Sa i takon kërkesave që i parashtroi grupi politik i përfaqësuar nga Rasim Fazliu janë; kërkesa shumë të arsyeshme pasi janë kërkesa reale dhe shqetësime reale dhe ne mund të bëjmë lëvizje të pozicioneve në këtë drejtim. Sa i përket kërkesave që i parashtroi në emër të grupit të LDK-së, disa sqarime që i kërkoj z. Fehmi Cena, po dua me ju sigurua se buxheti ka shkurtime buxhetore pra granti i përgjithshëm për komunat e Kosovës, që i vjen komunave është zvogëluar për 10% në çdo komunë ka shkurtime. Komunës së Rahovecit i është shkurtuar granti për 1.8% për shkak të pandemisë dhe jemi ende në kohën e shkurtimeve dhe në planin e të hyrave kemi 95,000 euro më pak kemi të hyra për shkak të pandemisë dhe 236,000 euro që gjithsej bëjnë mbi 330,000 euro kemi me pak buxhete sipas qarkores se tretë buxhetore. Ne jemi duke bërë debate edhe me MPL-në edhe me Ministrinë e Financave sepse Asociacioni i Komunave po e kundërshton zvogëlimin e buxhetit për komuna pasi ky zvogëlim është për të gjitha komunat por ne po mundohemi me rezistua sepse janë duke u përballur me shumë vështirësi nga gjendja e pandemisë por nuk na kanë pyet hiq dhe për herë të parë ka qarkore të tretë buxhetore ku ne për 335,000 euro kemi me pak buxhet për vitin 2021 pra mbi 95,000 euro janë më pak të hyra. Pra gjithë këto diferenca të shkurtimeve që edhe me herët i përmendi Masari janë të gjitha këto që me se miri i shpjegon drejtori i Financave dhe e di saktë sepse po ballafaqohem sakte me këto edhe si kryetar komune edhe politikisht në kuptimin bashkë me kryetarët e komunave tjera si këshillë i kryetarëve që po bëjmë përpjekje që mos me i lejua këto por ato po ndodhin edhe tash na duhet me i ulë vlerat dhe kjo ka të bëjë edhe me atë që ngrii Rasimi se pse janë zvogëluar disa vlera. Pra jemi detyruar edhe njëherë me bo përputhshëm buxhetin tonë për vitin 2021 me qarkoren e tretë buxhetore pra duhet diku me ulë vlera. Një çështje e parashtuar nga Fehmi Cena rreth rrugës Rahovec – Pataqan që është një kontratë shume e madhe financiare e cila ka pasur probleme serioze

edhe për sa i takon fizibilitetit dhe ju e dini se kemi mbërritur ta shtrojmë shtresën e parë dhe nuk kemi mundur të vazhdojmë deri te restoranti. Natyra për shkak të mungesave buxhetore. Kontrata është afër 800,000 euro, pra unë jam dakord që me përshpejtua dhe me shtrua edhe shtresën e dytë pasi kjo rrugë do të ketë dy shtresa dhe është në kontratë dhe duhet me u përshpejtua veprimet që me heq prej kodit që mu konsiderua e kryer por nuk mundemi me mbyll financiarisht krejt kontratën për shkak se obligimet janë më të mëdha por edhe aty mundemi me bo ndonjë kalkulim me bartjen e të hyrave në vitin e ardhshëm që me shtua vlerën financiare që me ju afrua përmbylljes së asaj kontrate. Te shëndetësia, kodi pra sistemi pip nuk na lejon me fut diçka pa e përmendur fjalën ndërtim, pra bëhet fjalë për renovim të repartit të pediatriisë por ne duhet me futë fjalën ndërtim pasi nuk e lejon ndryshe sistemi. Pastaj AMF- në Lagjen e Epërme pra ideja është me ndërtua një objekt shëndetësor ne pjesën ku është fusha sportive dhe dikush mundet me than se po kryejnë shërbimet ne QKMF apo ne ambulanten që është pak me poshtë se Lagjia e Epërme. Por përveç që është kërkesë e krahutshme por ata siç dini edhe janë pjesa me e varfër dhe kërkesa e tyre është legjitime te fusha e sportit pasi kemi pronë komunale. Te Shtëpia Muze e Ukshin Hotit, ne kemi pasur kodin e shtëpisë muze ne qeverinë e kaluar dhe është hequr nga qeveria Kurti dhe unë e kam pasur edhe debat kur ishte kryeministri Kurti këtu, pasi 120,000 euro të dedikuara për shtëpinë muze janë hequr dhe sipas kryeministrit Kurti se nuk ishte ne dijeni rreth kësaj por s'ka mundur me u rikthye dhe ndoshta rikthehet tash për vitin 2021 dhe ne i kemi lanë aty 30,000 euro se nëse kemi nevojë për bashkëfinancim me nënshkrua ndonjë memorandum të bashkëpunimit. Ne vitin e ardhshëm patjetër duhet me rifillua shtëpia muze pasi projekti ekziston, pasi në këtë vit nuk mundemi me i shpenzua sepse ishim në pritje që mos po kthehet kodi por nuk është rikthyer. Projekti është i gatshëm dhe vetëm ka me u shpallë tenderi dhe ne kemi pritë që ministria me krye punën edhe me bo financimin qysh e ka marr përsipër, prandaj insisto me mbet ky kod pasi shtëpia e muze duhet me u trajtua edhe faza e dytë e kompleksit muzeor. Muzeu në Krushë të Madhe, kjo është një vepër tjetër që Agjensioni i Menaxhimit të Komplekseve Përkujtimore ka marr përsipër që bashkëfinancim me komunën dhe ne i kemi falënderuar për këtë pasi për herë të parë agjencia po bën diçka për komunën tonë dhe ka marr përsipër me bë muzeun në Krushë të Madhe dhe që është një bashkëfinancim dhe po presim me ja nis punës pasi procesi është në vlerësim dhe shtëpia muze do të ndërtohet te varrezat Kompleksi i Dëshmorëve edhe Martireve në Krushë të Madhe. Pra duhet me dallua pasi ky është një projekt që bashkfinancon me komunën Agjencia e Menaxhimit të Komplekseve Përkujtimore në nivel republike dhe e ka marr përsipër një projekt tjetër në Reti me financua vet pra një memorial që e bashkfinancon vet në qendër të fshatit një memorial. Kontrata pritët me u lidh shpejt pasi sipas vlerës se parashikuar llogaritët 150,000 dhe financimi është përgjysmë pra ne mund ta votojmë tani për muzeun mirëpo paratë jepen vitin e ardhshëm e jo sivjet sepse nuk kemi mundësi për këtë vite por vetëm nëse do të kemi ridestinin të mjeteve atëherë vendimi merret në Kuvend. Tek shtëpia e masakrës në Krushë kemi problem shpronësimit pasi me vlerën financiare nuk pajtohet pala dhe jemi ne dilemë si do të ja bëjmë. Ne nuk kemi mundësi vetëm nëse kuvendi vendos ndryshe pasi e kanë vlerësua që është mbi 3900 euro vlera e shtëpisë nga departamenti për shpronësime dhe ata nuk janë pajtua edhe tash kemi problem për këtë dhe projekti nuk mund të zhvillohet dhe ne po insistojmë edhe nëse mbetet ky kodë me shpresën se mos po gjendët ndonjë zgjidhje. Unë po bëj përpjekje me mbet ky kod pa marr parasysh se ai edhe s'ka drejtë me rrënua atë edhe s'po na jep të drejtën me operua aty pasi ai nuk po e akuzon komunën por po e akuzon departamentin që e ka vlerësuar me atë vlerë qesharake. Pastaj qendra kulturore multifunksionale inovative për kulture dhe rini, ne e kemi ruajte si kodë eventualisht pasi e dimë që me 10,000 euro nuk bëhet ajo punë dhe ne po shpresojmë që me planifikimet për vitin 2021 këtë projekt do ta merr Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Pra do të bëhet një objekt dhe supozohet se do të bëhet këtu ku ka qenë shkolla që është rrënuar por prapë vendimi se ku do të bëhet e madje edhe duhet me u bo dëgjim publik por ne po shpresojmë që nëse futet ne kuadër të Ministrisë se Kulturës rinisë dhe sportit të bëhet një objekt i cili pre supozohet që detyre projektuese ata që e bëjnë ka me pas edhe si sallë të kulturës pra një objekt bashkohorë

edhe multifunksional dhe i përshtatshëm për një mori aktiviteteve edhe për kulture edhe për rini edhe për inovacion dhe plot gjëra të tjera, pasi nuk e dimë se si do të duket tash por ne po luftojmë me marrë prej Ministrisë së Kulturës apo Qeverisë së Kosovës financimin dhe ne momentin kur kemi informatën atëherë ju sjellim në Kuvend dhe ju tregojmë si do të bëhet edhe normalisht që vendimin e marrim prapë në kuvend. Te shkolla në Xërxe, unë jam në dijeni se është futur në Ministrinë e Arsimit ndërtimi i shkollës së re objektit të ri të shkollës së Xërxës dhe ne nuk kemi kapacitet për momentin me buxhetue për shkak se jemi në ndërtim të objekteve të reja shkollore dhe çerdheve në komunën tonë dhe nëse mbetet kjo qeveri për mendimin tim kanë me buxhetue ata se paku kështu e kam informatën dhe pavarësisht se ne kemi fitua edhe një projekt për efikasitet të energjisë në atë shkollë por sigurisht se jemi të interesuar me bo edhe nderimi e re të shkollës. Përfillja e kërkesave të qytetareve që ju i keni bërë e keni parë edhe neper dëgjime publike nuk është vetëm prej komunës por edhe ajo që çka bën komuna me qeverinë për me marrë mbështetje. Te guri i kuq për dy rrugë që është edhe kërkesë e asamblistit Ali Morina, e përmenda edhe me herët se nesër i nënshkruajmë kontratat që 3 operatore kanë me ndërtua rrugë në komunën e Rahovecit pra ne qytet edhe ne fshatra pra rrugë prej 50 metra e deri në 500 metra e sigurisht që janë të përfshira edhe ato dy rrugët në Guri i Kuq brenda kësaj kontrate që nesër e nënshkruajmë. Unë po besoj që ne kemi mundësi tash edhe me grandin e performancës 656,000 euro e stabilizojnë krejt procesin e investimeve publike në komunën tonë dhe tash nuk guxojmë me i buxhetue tash pasi ne projektet e reja i keni pa vlerë, pasi njëherë duhet me u krye disa procese në nivelin qendror dhe unë po besoj që ne kemi pasur mundësi që me marr edhe ide nga ju për ndonjë investim në të mirën e qytetareve të komunës tonë.

Fehmi Hoxha – I nderuari Kryetar, sikur të isha në vendin tuaj i kisha lutë krejt këta kuvendarët më mbështet edhe mos me votua këtë buxhet. Arsyeja është shumë e qartë pasi po i humbim 350,000 euro dhe nëse ju kujtohet në mandat 600,000 se PDK-ja nuk e ka votua dhe kjo është e vërtetë edhe sigurisht edhe tani nëse e votojmë këtë buxhet do i humbim 350,000 euro. Në bazë të ligjit për buxhet nëse nuk e votojmë këtë buxhet atëherë 350,000 do të kemi sepse përshkruhet buxheti i vitit të kaluar. Por nëse veç keni vendos me diskutua rreth këtij buxheti se unë paraprakisht edhe qëndroj se 350,000 i humbim tash nëse e votojmë këtë buxhet, atëherë shefi i grupit të PDK-së i prezantoj qëndrimet e grupit të PDK-së dhe ato janë shume të qarta edhe njëherë do të mundohem me i sqarua, e para shtëpia muze në Krushë të Madhe e mbështes pasi e kam parë një dokument që është shumë i mirë dhe një projekt që po bëhet shumë i mirë edhe sigurisht që i duhet komunës tonë me pas një shtëpi muze mirëpo shumë të drejtë e ka shefi i grupit të LDK-së që vendimi merret në Kuvend pasi kuvendi komunal menaxhon me hapësira publike dhe se pari duhet të merret vendim për ndërtim e pastaj janë projeksionet buxhetore dhe ndarjet buxhetore dhe për çdo ndërtim merret vendim këtu në Kuvend pasi kuvendi komunal menaxhon me pronat dhe hapësirat publike dhe merret vendimi këtu. Keni bërë shume mirë që e keni nënshkrua memorandumin e mirëkuptimit me agjensionin përkatës mirëpo në kuvend duhet të merret vendimi dhe ne nuk e kundërshtojmë por procedurat ligjore duhet të kryhen. Rreth propozimit të shefit tonë, dua të jap disa sqarime pasi ju e diskutuat për kodin i cili është 70,000 euro për trajtimin e ujërave atmosferik dhe na shpjeguat se kompania Mendi do të fillon punimet dhe propozimi jonë është i qartë dhe nëse ju kujtohet që shtëpinë e kulturës kur ishim ju thash se keni filluar me arrua pasi vërtet është ashtu pasi ka shume ujëra nëntokësore në rrugën kryesore që lidhet prej qendrës pra fillimi i rrugës sheh Myhedini pastaj rruga Selajdin Mullaabazi dhe komplet rruga Xhelal Hajda Toni. Pra jemi duke folur për një projekt madhor ku do të duhet të ndërtohet një qendër administrative komunale që quhet Rahovec. Nuk është trajtuar asnjëherë dhe çdo qeveri komunale ka bërë arrime dhe ky projekt sipas mendimit do të kushton 1 milion euro mirëpo duhet të fillojmë ta bëjmë atë se asnjë zgjidhje tjetër nuk jemi duke bërë as ne që kemi menduar më herët e as ju për këtë kanal ose baj pasi të kyqet në lumin Duhlllo, pra nuk është kjo zgjidhje pasi atëherë kur është bërë projekti i lumit Duhlllo është i projektuar ngushtë edhe pse të garantuar edhe projektuesit për këtë mirëpo kjo po del që nuk kanë asgjë dhe është i ndërtuar shume cekët pasi është përmblytje shume e madhe në atë pjesë dhe ne gjate qeverisjes

tonë kemi shikuar se çka mund të bëjmë me sanua dhe kemi ndërtua disa mure mbrojtëse që kanë rezultue që janë pozitive mirëpo tek familjet Canziba aty çdo here ka vërshime dhe uji futet në shtëpitë e tyre. Pra pa e realizuar këtë projektin madhor që është për komunën e Rahovecit e në këtë rast për kryeqendrën në Rahovec që ta bëjmë njëherë e përgjithmonë trajtimin e ujërave atmosferik dhe të zeza të cilat janë të ndërtuara në vitet e 60-ta dhe vazhdimisht është shkuar me arnime pra duhet të behet ai projekt. Propozoj të projektohet në projeksionin buxhetor trajtimi i ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza në rrugën Selajdin Mullaabazi, Xhelal Hajda dhe rrugën Fahredin Hoxha. Në rrugën Fahredin Hoxha unë banoj në atë lagje dhe komuna më herët gypi i kanalizimit është 300 dhe kyqet në 200 që ne si qytetar e kemi bërë por tani jeni duke ndërtuar me 600 që është shumë mirë në atë pjesë që është rruga Asllan Kleqka dhe kjo është e pamundur diçka të behet pasi gypi 600 nuk futet në gyp 200 pra ajo duhet të trajtohet me 600 që komplet rruga Selajdin Mullaabazi priset dhe kur e keni ndërtuar atë asfalt ju kujtohet menjëherë të nesërmen ka shpërthyer bash te shaktet. Pra duhet të vendoset në projeksion buxhetor trajtimi i ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza në rrugën Selajdin Mullaabazi, Xhelal Hajda dhe Fahredin Hoxha, që ishte edhe propozimi i shefit tonë që kemi marr vendim si grup i PDK-së. Një punë shumë e madhe është kryer nga ana juaj dhe nga ekzekutivi gjë që ju kam lavdëruar publikisht edhe tani po ju lavdëroj se keni arritur përmes qeverisë me marr me rikthye pronën komunale të cilën e ka menaxhuar Agjensioni Pyjor i Kosovës tek epopeja e UÇK-së ku aktualisht është duke u ndërtuar edhe shtëpia për pushimin ditor të pleqve dhe ku është planifikuar të bëhet stadiumi. Është shumë e vërtetë se do ta merr federata por komuna duhet me pas një projeksion një kod buxhetor për me lidhë bashkëfinancimin, pastaj Kuvendi Komunal këtu duhet të merret vendim për përcaktimin e parcelës sa hektar janë aty që me marr na vendim për ndërtim atje dhe kjo nuk ka ndodhur nga ana kuvendit komunal për ndërtimin e stadiumit atje dhe mendoj se duhet me nda një pjese të buxhetit pasi e dimë që shumë mirë se ka filluar dizajnimi i sheshit të qytetit ku përfshihet edhe stadiumi i qytetit ku urgjentisht duhet të bartet nëse duam të realizojmë këtë projekt që realisht është projekt shume i mirë mirëpo duhet të bartet dhe ne duhet të jemi një hap para të tjerëve dhe ti ndajmë mjetet buxhetore së paku 100,000 euro për fillimin e punimeve të stadiumit. Pastaj kërkesë tjetër ishte edhe rrethojat shkollës fillore në fshatin Çifllak, që është vërtet se është shumë e nevojshme pasi aty ka shumë qenë endacakë dhe nxënësit e shkollës aty dhe përgjithësisht fëmijët e fshatit Çifllak janë të rrezikuar dhe është mirë kjo të hyjë në projeksion buxhetor në kuadër të buxhetit pra grandit specifik që e ka drejtoria për arsim. Pastaj disa kode që ishin me zero, këto mund të plotësohen pas marrjes se grandit të performancës rreth 600,000 euro mirëpo është e pakuptimit tek drejtoria urbanizmit figuron mbikëqyrja e punimeve me zero. Me ligj ekzekutivi është i obliguar për çdo herë me shpallë tenderin për mbikëqyrjen e punimeve, tash aktualisht nuk e di edhe sa ka kontratë operatori aktual mirëpo gjithsesi duhet me vendos 10,000 apo 20,000 dhe me pritë plotësimin e asaj. Në mungesë të kontratës, kryetari ka të drejtë me bo vendim për mbikëqyrjen e brendshme në mungesë të kontratës mirëpo ka për obligim me shpallë tenderin deri sa të procedurat e tenderimit nuk kryhen.

Kryetari – Unë e kuptoj konstruktivitetin e z. Fehmi Hoxha dhe me te vërtet edhe ka shume njohuri dhe është në thelbin e problemit të ujërave atmosferik. Unë në komunikim me disa miq dhe me patën thënë që Shtutgarti i Gjermanisë që ka të njëjtat probleme pasi kanë investua shume dha ka vazhdimisht probleme për shkak të pozitës që ka. Dhe ajo çka dua të them se ne kemi filluar këtë punë dhe besoj që komuna e Rahovecit ka me dhanë kontributin e jashtëzakonshme me kapacitetet sepse unë ja kam nisë mirëpo pak rëndësi se kush është pas një viti, por unë e kam nis një projekt që kërkon edhe kosto e po ashtu edhe ekspertizë sepse uji po vjen nga të gjitha anët qytetit që ne duhet me gjete mundësi me kanalizua edhe me bo një shkarkim me te kontrolluar në kanalet e shkarkimit siç është lumi Duhlllo apo lumin Rimnik. Ne kemi lidhë një kontratë e cikla ka filluar punimet dhe unë jam i bindur se nuk ka me mbet me kaq sepse ju e keni pa në 2 apo 3 vende ka trajtimi i ujërave atmosferik që janë të përgjithshme por ne i dimë tash ku jemi sepse po mundohemi që me i evitua në vendet ku janë me problematike siç kemi kod të veçantë për Rimnik në

Fortesë pastaj për Celinë po pres me qit kodin e ri që po e hapim që janë me vlera zero pasi grandi i performancës ende është në procedim dhe na mbetet që në plotë aspekte me u pozicionua edhe ka qyteti që është shumë problematikë edhe duhet pasi ata kanë garantua edhe prapë garantojnë që kur të bëhet sheshi i ri ndoshta kjo ura që është te podrumi i vjetër pasi në bazë të matjeve të inxhinierëve të hidros dhe janë përcaktuar nga gryka dhe perimetri i urës dhe na kanë garantuar që gjithë kapaciteti i hyrjes së ujit në këtë urë nuk mundet me u ndal diku edhe me u vërshua por duhet ta kemi parasysh se po hyn edhe nga pjesë tjera edhe pastaj po kemi vërshime edhe sigurisht që tash kjo kërkon zgjidhje. Unë thash se pajtohem që të shtohen mjetet financiare dhe për këtë duhet me na tregua drejtori i Financave. Për emrat e rrugëve ju mos shqetësohuni sepse ne nuk mundemi me ditë nga këtu pa një ekspertizë të inxhinierëve të arkitekteve dhe pa dalë për konsultime në terren me i pa nga afër senet nuk mundemi me dit dhe nuk është dëshira ime dhe besoj edhe askujt që me fol pa e ditur. Unë jam në dijeni për ato rrugë edhe sigurisht që jam në dijeni se ka probleme por sidoqoftë neve na duhet një konsultim profesional me ata që din dhe deri sa kodi është i hapur dhe derisa shqetësimi mbetet ne top listën e prioriteteve trajtimi i ujërave atmosferike edhe mënjanimi i i përmbytjeve që po i shohim edhe vetë siç e thashë edhe më herët sepse në perimetrin e lumit janë të ndërtuara ato shtëpi edhe mungesa e izolimeve adekuate e po ashtu edhe ka probleme pronësore e krejt këto situata janë që duhet me u trajtua me shumë kujdes. Por ajo çka mundem me ju siguria në këtë kuvend dhe qytetarët e Rahovecit se ne e kemi shumë seriozisht me u marr me ujërat atmosferik në qytet dhe jam banues këtu edhe e shoh vazhdimisht problemin me ujërat atmosferik. Ne nuk mundemi me zgjidhë por mundemi me minimizua këtë problem sepse vërtetë po kemi vërshime të mëdha dhe po na krijon probleme shtesë për me bo pastrimin e qytetit. Pra jam për me shtua mjete aq sa ka mundësi dhe për këtë na tregon drejtori i Financave z. Afrim Limani. Po ashtu mund të them se sheshi qendror i qytetit, ideja është me hy në planifikim nga qeveria e po shpresoj nga donatorët që realisht tek në mars apo në prill llogaritet me fillua ekzekutimi i një kontrate potenciale për sheshe. Nëse nuk ndihmon ndonjë donator edhe qeveria pasi bëhet fjalë për shifra të mëdha pasi ne nuk e dimë ende sepse është në konkurs ndërkombëtar të projektimit por sido qoftë ne luftojmë për me gjetë donatorin që e financon pasi komuna e Rahovecit me buxhetin që ka e ka të pamundur me realizua diçka në këtë drejtim. Te stadiumi ku pretendohet me u ndërtua, pronën e kemi marr nga Agjencioni Pyjor me vendim të qeverisë dhe aty do të bëhet stadiumi ndërsa këtu do të këtë situata pasi e kemi marr vendimin në Kuvend për me miratua në momentin kur drejtori i urbanizmit e ka qit në kuvend. Pra zhvendosja e stadiumit është zgjidhje edhe për sportistët për palestrën për qytetin sepse qendra e qytetit sigurisht më moderne po krijohet poshtë. Agjencioni Pyjor i Kosovës kur ja ka dhanë qeverisë me vendim të qeverisë na ka dhënë edhe neve edhe sigurisht se e ka ditë se pse po e marrim na pasi do të bëhet kompleks sportiv edhe sigurisht edhe një pjesë do të shfrytëzohet për nderimin e stadiumit. Besoj që shtëpia muze në Krushë të Madhe që bëhet fjalë për pronën e Vakëfit edhe është interes të përgjithshëm që nga viti 2012-2013 pra fjala është për muzeun në Krushë të Madhe në kuadër të kompleksit të varrezave. Ndërsa për kompleksin e Ukshin Hotit, ju tregova edhe më herët situatën si e kemi pasur, është dashtë të filloj sivjet por ne jemi vonua në pritje mos po rikthehet kodi i humbur. Te vendimet e kuvendit, të muzeut që e ka marr agjencioni përsipër për me bashkëfinancua, ne mund ta miratojmë apo jo por kur të lidhet kontrata duhet me gjetë mënyrën për me pagua obligimin tonë, pra është marrëveshje bashkëfinancimi me agjencinë ndërsa për stadiumin është marrëveshje financimi pra plotësisht e financon Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve pra stadiumin ne Rahovec, palestrën në Krushë dhe stadiumin në Ratkoc. Unë e ftoj Kuvendin e Komunës së Rahovecit, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit me votua buxhetin, ndoshta ne mund t'i humbim 330,000 euro por duhet ta dini që po i humbim të gjitha komunat për shkak të pandemisë e bile komunat tjera humbim me shumë por i fitojmë 656,000 euro grant dhe besoj që do të ishte mirë me votua buxhetin pasi është ngjarja me e madhe e një komune, e di që ndoshta edhe nuk i plotëson kërkesat dhe ambiciet që i kam shumë të mëdha që me bë sa më shumë punë por sigurisht që edhe ju e dini që do të luftojmë bashke që këtë buxhet që e kemi që me e rritë sa më shumë për vitin 2021 sepse të gjithë kemi

dëshirë me rritë që me fitua ndonjë donacion apo projekt apo grant. Unë jam i bindur që po hyjmë në një gjendje normale financiare dhe stabilizohemi edhe më mirë për vitin 2021 dhe sigurisht që me krijua mundësi që me bo projekte që u fol nga shumica e asamblastëve që me pas kërkesa legjitime. Ne edhe në kode të përgjithshme e dimë se çka kemi me bo e sigurisht që e kemi edhe ndihmën tuaj por duhet të jeni të bindur që shumica e gjërave mund të përfshihen prandaj ndonjëherë duhet me i lanë edhe kodet e përgjithshme sepse kur është kodi specifik atëherë është problem pastaj me ndërhyje që me pas mundësi me bo edhe ndonjë punë tjetër, kështu që në kode të përgjithshme, ne kanalizim të ujërave të zeza, kanalizim të ujërave atmosferik, shtretër të lumenjve në bujqësi mbështetje të bizneseve në bujqësi urbanizëm plane shesh dhe krejt këto janë të standardizuara dhe të përfshira në atë mënyrë që të gjithë do të jenë të kënaqur me kapacitetet buxhetore duke e ditur paraprakisht sa i ka komuna e jonë. Ju ftoj me votua buxhetin e vitit 2021 edhe me zotimet që do të përmirësojmë disa vërejtje që i dhanë shefat e grupeve të kuvendit dhe unë jam për me votua pavarësisht që ne kemi dallime në shume tema por kryevepra e një komune është buxheti, pasi pa buxhet është e pamundur me mbijetua komuna, sigurisht që nuk i ka përshtirë të gjitha kërkesat e qytetareve për shkak të pamundësisë si buxhet i vogël por i ka përfshi temat kryesore që edhe ju i keni debatuar si KPF edhe dëgjimet dhe komunikimet që ne i bëjmë, sigurisht që nuk mundemi me i mbërri me buxhetin që e kemi por sigurisht mundem me i mbërri edhe me buxhetin shtesë që do ta kemi.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, rreth organizimit të buxhetit, unë besoj që sivjet është bërë pak më mirë në një relacion dhe gjithmonë kam qenë pro përmbylljes së projekteve ekzistuese dhe sa me pak të hapen projekte të reja përderisa janë me obligime kontraktuale. Unë sivjet po shoh pak projekte të reja dhe kjo besoj që është pozitive dhe e stabilizon komunën në aspektin fiskal. Pastaj të projektet ekzistuese dilema që kemi pasur, tani po flas vetëm për veten time pasi e dini publikisht se nuk jam pjesë e grupit të PDK-së por po e vazhdoj mandatin si asamblist i pavarur dhe në këtë pikëpamje e jap një mendim, tek kodet e projekteve në bujqësi që realisht janë 3 projekte dhe në shëndetësi projekti i katërt kam pasur dilema se po bëhet se po bëhet shkelja e ligjit dhe kam pritur që Auditori Gjeneral vërteton këtë bindje që e kemi pasur mirëpo fare nuk e ka marr në shqyrtim këtë lëndë dhe po na jep një sinjal që me besua që ka ndodhur diçka që ka me pak se shkelje apo me pak se e lejume dhe nuk jam i interesuar që me i ndal këto projekte ngase bujqit vërtet kanë përfitua shumë nga këto kode ekzistuese. Po ashtu po vazhdoj me shëndetësi, të njëjtën dilemë e kam pasur për projektin që ndahet nga grandit specifik për shëndetësi, ndërtimi shtëpive dhe materialeve ndërtimore për familje në nevojë, jo për ta pengua projektin ngase nevoja është shumë e madhe që të vazhdoj ky projekt dhe kërkesat kanë qenë enorme që të përkrahen nevojtarët për asistencë për ndërtimin e shtëpive mirëpo duke ditur që grandit për shëndetësi është nga grandit që mbrohet me ligje grandit për arsim dhe shëndetësi dhe nuk guxojnë të dalin mjete nga shëndetësia në një fushë tjetër mirëpo edhe këtu auditori me gjasë e ka mendua që ndërlidhet në aspektin socialë dhe nuk i ka prekë fare, andaj edhe këtu nuk jam për me ndryshua. Përndryshe e mirëpres projektin e ri që është ndërtimi rregullimi meremetimi i repartit të pediatriisë dhe stomatologjisë. Unë kujtoj që mandatin e kaluar e kemi ndërtuar repartin e hemodializes që është në repartin e katit të përdhësës dhe në atë model besoj që duhet të ndërtohet komplet objekti dhe të shkohet deri në maternitet dhe kujtoj që ai objekt nuk ka izolim fare dhe duhet të llogaritet edhe izolimi i tij, me një arsye që brenda shëndetësisë primare kemi inkuorporua disa shërbime sekondare dhe disa aktuale që i kemi siç është urologjia pediatria edhe 5 specialistë që i kemi financua mandatin e kaluar e që tash janë specializua dhe ne mund të lëvizim drejt një hapi të cilin duhet ta ndërmerr kuvendi duke u bazuar në nenin 17-të të ligjit për shëndetësi për themelimin e poliklinikës sekondare apo mini spitali pa trajtim të shtratis. Këto i ka bërë komuna e Podujevës para 3 vitesh dhe ne duhet të marrim model dhe shpresojmë se dializa të funksionalizohet dhe kjo do të jetë një adutë shumë e sigurt që të lëvizim përpara si shëndetësi. Ndërsa te projekti i ujërave të shiut që gjate pyetjes që shtrova, kryetari e dha sqarimin e vet mirëpo unë do të kërkoj që ky projekt që tash po fillon se zbatuari që kyçja e tij të mos bëhet në lumin Duhlllo pa e trajtuar shtratin prej segmentit ku do të bëhet kyçja dhe propozoj që kyçja të bëhet sa

me poshtë në mënyrë që trajtimi i shtratis të bëhet në segment sa me të shkurtë dhe nuk ka zgjidhje tjetër pasi inxhinierët kanë folur pa me herët mirëpo edhe ata nuk do të thotë që nuk gabojnë, po jap vetëm një shembull si segmenti që lidhë rrugën Gëzim Hamza me rrugën Ibrahim Rugova, shpesh here kam folur se secili shi shkakton përmbytje për shkak të vendosjes së një muri të pavendosur mirë d.m.th. që ai mure e mbron ujin që të vazhdon teposhte edhe një pjesë e lagjes përmbytet. Pra do të ishte mirë që për këso projekte i propozoj kryetarit që të i ftoni banoret e lagjes për diskutim këtu në kuvend komunal edhe me i dhanë sqarimet e nevojshme por sigurisht edhe me i marr preokupimet dhe brengat e tyre pasi vërtet rrezikohet edhe jeta e njerëzve, po ashtu në mundemi me kuptua që mund të ketë edhe uzurpime por brenda shtrati ekzistues mund të bëhet një ndryshim i vogël i projektit pra të mos zgjerohet projekti por të thellohet e sidomos aty ku bëhet kyçja e ujërave të qytetit prej pompës së benzinës që vijnë në atë kanal dhe prej atij pozicioni duhet patjetër të bëhet thellimi i kanalit përndryshe do të jemi në pozicionin që me mbyllë një problem e me hapë disa të tjerë. Pra unë jam shumë i bindur pa politikë pasi e përcjelli një brengë të qytetareve me të cilën ballafaqohemi në secilën reshje të shiut. Po ashtu keni edhe kodet me bashkëfinancim që mund të bëni një projekt edhe të konkurroni në Ministrinë e Planifikimi Hapësinor mirëpo mos të shkojmë ka ajo që të kyçemi në kanalin edhe me pae pastaj se çka po ndodhë dhe sigurisht se ka me ndodhë një përmbytje shumë e madhe edhe dëmet kanë me qenë kolosale.

Kryetari – Munib, ne jemi të gatshëm me i takua edhe banoret e lagjes pa asnjë problem dhe nuk jemi asnjë këtu prej atyre që me zgjidh një problem e që me u hap shumë të tjerë. Por kjo çështje që unë po e rezervoj të drejtën që me i takua edhe në terrene banorët. Unë fola për një shkarkim të kontrolluar i cili do të bëhet me kaskada edhe sigurisht që nuk do të shkoj uji ka nuk duhet sikur të puna e hidrocentraleve dhe folëm për punë elemente shtesë të cilat a do të jenë thellim i shtrati apo do të jenë mure tani nuk mund të them pasi për çështjen e ujërave i kom mbledhë mbi 25 arkitektë dhe inxhinier të kësaj komune dhe zgjidhjet parimore dhe me të drejta teknike profesionale janë dhënë duke u nisur në ndërtimin e kanaleve. Pra ne kemi fillua me i dhanë kuptim përmes një projekti që është veç në nisje problemit të ujërave atmosferik e jo duke e zgjidhë problemin në rrugën Xhelal Hajda e duke ju shkaktuar problem dikujt tjetër por duke i trajtuar në shumë kujdes dhe ne do të jemi këtu dhe nëse kemi vështirësi rreth kësaj nuk jemi të interesuar me krijua dhe po ju sigurojë se nuk jemi të gatshëm me shkaktua përmbytje duke i eliminuar përmbytje dikën tjetër dhe me shkaktua përmbytje diku tjetër e sidomos në pjesën e banuar. Tash cila do të jetë zgjidhja unë po e rezervoj të drejtën dhe ne do të bisedojmë edhe me banoret edhe me ju si përfaqësues i banoreve apo i zgjedhur edhe i atyre banoreve por edhe me inxhinier arkitekt apo me kompani që me këtë kontratë që kemi a mundemi me bo diçka me ndryshe, pra krejt këto mundemi me i bisedua se a lejohen diçka me ndryshe sepse lejohen korrigjimet edhe brenda kontratës nëse menaxheri konstaton dhe nëse banoret kërkojnë diçka me ndryshe atëherë i shohim edhe i harmonizojmë edhe besoj që do të jemi këtu. Edhe njëherë po ju ftoj me votua buxhetin me disa korrigjime që unë kam një propozim konkret që ftojë drejtorin e Financave dhe shefat e grupeve parlamentare që të konsultohen për detaje tjera që me shikua se çka mund të bëhet për ndonjë korrigjim eventuale. Unë u zotova për atë që e thash, ujërat atmosferik kanë marrë kuptim dhe kanë fillua me u trajtua pasi vërtet asnjëherë nuk është shtruar si çështje me prioritet vërshimet mirëpo tani duke parë gjendjen e vazhdueshme nga reshjet e shiut dhe vërshimet që po shkaktohen dhe ne duhet tash me i dhanë kuptim kësaj që të bëhet njëherë e përgjithmonë rregullimi i kësaj çështje. Çështja e rrethimit të shkollës në Çifllak, nuk ka vend për këtë, pasi ajo do të kryhet shumë shpejt me këtë kodë pra me këtë kontratë që e kemi për riparimin e shkollave. Po ashtu edhe kërkesat e z. Fehmi Hoxha, i dimë shumë mirë ato problemë dhe tash ju them ehe ne emër të Drejtorit të Shërbimeve publike z. Përparim Krasniqi po shpresojmë edhe koha të përmirësohet do të trajtohet kanalizimi fekale edhe problemet e tjera që janë të pranishme në lagjen tuaj dhe mirë që e kemi kontratën për ujërat e zeza, që realisht janë larguar pak për shkak të reshjeve, pra sigurisht se do të intervenohet në këtë vite në rrugën Fahredin Hoxha dhe mbi këtë

bazë unë po kërkoj me votua, e di secili nga ju vazhdimisht mund të kërkon diçka e që sigurisht se është legjitime por sigurisht që legjitime është me u zotua për disa punë që munden me u krye.

Sali Sallteku – Nga ajo që po e shoh dhe kam lexuar deri me tani, vërtet kësaj here ka pasur më pak mjete edhe e kuptoj edhe drejtorin e Financave për arsyetimin edhe ka bërë shumë mirë që e ka sjellë këtu dhe nëse e krahasojmë me buxhetin e vitit të kaluar atëherë del se ky është shumë më i mirë se ai tjetri edhe pse i ka këto rënie, pra është mirë me krye tani buxhetin.

Fahrie Lushi – I nderuar kryesues, kryetar, kolegë këshilltar dhe gjithë ju të pranishëm. Së pari unë e përmend një fakt që më ka bërë me u ndie mirë dhe që është mirë që është përmendur edhe nga të tjerët si specifikimi i kodeve, nga kode përgjithësuese në kode specifike, ani pse kryetari e arsyetoj këtë dhe e kuptoj plotësisht që tha se prej kodeve të përgjithësuese mundemi çdo kund tjetër me ndërhyje dhe unë e përgëzoj këtë fakt që u ngritë kjo temë sepse vitin e kaluar e kam ngritë edhe unë personalisht. Edhe disa çështje dhe shqetësime që kisha lidhur me buxhetin, kryetari paraprakisht i dha përgjigjet dhe po e dimë se cilat janë problematikët që e shoqërojnë këtë buxhet pra këtë qarkore që thjesht është në kohën në të cilën është, por unë do të ndërlidhesha vetëm pak tek arsimi dhe shkenca sepse janë kode që të gjithë besoj i kemi parë si riparime në shkollë vazhdim, e kuptoj edhe kryetari e dha paraprakisht këtë mirëpo shqetësimi im do të ishte për drejtorin e arsimit që në cilat pjesë do t'i kushtonit më tepër rëndësi dhe unë sugjeroj që me tepër me i dhanë rëndësi nyjave sanitare sepse është vendi ku fëmijët pa përkujdesje as nga arsimtaret dhe nga askush tjetër frekuentojnë vetëm dhe e kemi gjendjen pandemike para vetes.

Ali Zhuniqi – Shumica u ceken edhe ne fillim edhe keq klasifikimet edhe kodet pastaj ndryshimi i emërimit të kodeve, por dua të jem me konkret pasi ne kemi konsideruar që në kuadër të buxhetit edhe projeksionit të këtij buxheti si investime kapitale për me votua këtë buxhet është në Fortesë rrjeti komplet i kanalizimit, ndriçimi total i fshatit edhe rregullimi i rrugës prej xhamisë e deri në Celinë, rrugë kjo që është në gjendje katastrofale dhe e kemi cekur edhe vitin e kaluar se nuk është ndërmarrë diçka në lidhje me këtë sa i përket rrugës. Poashtu në Çifllak, na është ardhë një kërkesë nga ana e banoreve sa i përket një rrugë e cila nuk është as e kubëzuar e as e rregulluar nga ana e komunës dhe të merret parasysh si propozim. Pastaj në fshatin Pastasel kemi marr kërkesa se kanë nevojë për një objekt shkollor të ri edhe pse objekti që është fituar një projekt për eficiencë në atë objekt, por pavarësisht kësaj kryetari e ceku më herët se ka fituar një projekt për eficiencë për një shkollë tjetër pra fjala është për shkollën fillorë në Xërxe, po ashtu në fshatin Pastasel kanë mungesë të infrastrukturës sportive dhe kisha konsideruar që duhet me marr parasysh si kërkesë. Pastaj në fshatin Opterushë kemi mungesë të ndriçimit publik në disa zona madje në disa zona janë vërtetë shumë keq. Dhe si kërkesë e fundit për bujqit edhe në shëndetësi e posaçërisht në shëndetësi nëse do të ishte e mundur brenda kodit buxhetor probleme të teknologjive të reja dhe llogaritet afër 319,000 euro për blerjen e një mamografi për gratë dhe motrat tona që kanë nevojë për me i krye shërbimet që mos me udhëtua për Prishtinë Gjakovë apo diku tjetër. Edhe një kërkesë tjetër nga qytetareve të Rahovecit është për kyqje në sistemin e ujitjes, sistem i cili ka shkuar deri në Fortesë apo Pataqan, që po ashtu edhe kanë nevojë të kyqen në sistemin e ujitjes për bujqësi. Këto janë kërkesat konkrete që mendojmë se duhet të merren parasysh nga ana e kryetarit.

Trajko Shariq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Fillimisht do të jem i shkurtër, ajo çka dua të them është në lidhur me buxhetin e ndarë për komunitetet pasi buxheti është i vogël nëse e krahasojmë me kërkesat e lagjes dhe marr parasysh infrastrukturën e dobët që e kanë dhe problemet me të cilat ballafaqohen ata. Andaj edhe kisha propozua të rritet nëse ka mundësi buxheti i paraparë.

Kryetari - Ne e kemi adresuar kërkesën e Rasim Fazliut në emër të grupit të PDK-së ku shuma prej 50,000 euro nga kodi për shërbime publike hiqet dhe vendoset në kanalin e ujërave atmosferik në qytet dhe më tepër nuk kemi mundësi kështu që nga 70,000 bëhen 120,000 dhe unë po luftoj që edhe me ridestinim me pas një pozicion jo të kuvendit të komunës por tepëricat e qeverisë gjithashtu edhe me bartje të mjeteve presim me pas prape prioritet në kanalin e ujërave atmosferik, pra e kemi adresua shqetësimin që ishte ne

kuadër të grupit që është në emër të Rasim Fazliut të zotimi për Çifllak për rrethimin e shkollës fillore dhe poashtu e kemi dhënë zotimin që brenda këtij viti të kryhet kanalizimi fekal në kërkesat e Fehmi Hoxhes, e kemi sqarua mirë pozicionin në raport me Fehmi Cenën në sqarimet të cilat i ka kërkuar ne ato që i ka paraqitë që mund të ketë edhe porcione tjera qoftë për ambulantën apo për repartin e pediatriisë e qoftë edhe në kërkesa tjera, mund të bëhen pjese e kontratave tona dhe mund të lidhim përsëri kontrata në vitin 2021, po ashtu kërkesat që i ka paraqit Ali Zhuniqi sa i takon Pastaselit dhe i them se ne kemi kod për terrene sportive dhe mirëpresim një kërkesë nga kryesia e fshatit, po ashtu edhe sa i takon infrastrukturës rrugore veç kemi kod dhe nesër e nënshkruajmë kontratën për të gjitha rrugët ku nuk janë të kryera do të trajtohen dhe ne kemi kontratë për ndriçim publik në Fortesë në Oplotushë e gjithandëj, po ashtu kemi kontratë edhe për kanalizim të ujërave të zeza. Pastaj te mamografi jemi në proces pasi kemi aplikua me Ambasadën Japoneze dhe shpresoj që kemi me fitua si komunë pasi është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Po ashtu e kemi adresuar çështjen te qendra kulturore inovative multifunksionale për rini e kulturë dhe synojmë ta marrim nga qeveria, kurse për lokacionin flasim në kuvend. Po ashtu jemi të vetëdijshëm për shkurtime buxhetore të cilat janë për shkak të pandemisë, kemi edhe kode të përgjithshme e po ashtu edhe kode të veçanta që sigurisht është shumë mirë për këtë pasi kemi bërë njëfarë kombinimi që me pas mundësi operimi sipas prioriteteve që mund t'i kemi. Në pyetjen e parashtruar nga Trajko për Lagjen e Epërme, ne e dimë se buxheti është i pamjaftueshëm në raport me kërkesat dhe shqetësimet që i kanë ata, por ju e dini se na kemi ndërmarr edhe shumë veprime bashkë me donatorin sepse është i vetëdijshëm edhe i ndërgjegjshëm edhe Trajko sepse Lagja e Epërme konsiderohet edhe nga donatorët më mirë se sa lagjet tjera edhe marrim projekte edhe nga donatorët dhe besoj që do të kemi mundësi me ju përgjegjë një numri të madhe të kërkesave dhe nevojave që i keni ju.

Rasim Fazliu – Të gjithë këtu anëtarët e kuvendit e dhanë kontributin e vet për propozim buxhetin për vitin 2021 dhe është mirë kjo e po ashtu edhe kryetari para neve dhe qytetarëve e dha zotimin që do t'i realizoj ato projekte dhe kërkesa që na i patëm kështu që unë mendoj se këtu çdo gjë është e qartë që projektet të realizohen, tani ka mbet që veç me i qit në propozim edhe e votojmë buxhetin edhe ecim tutje. Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi botërisht foli se do të i realizoj këtë projekte dhe kërkesat ishin ato dhe na premtoj se do të realizohen që të gjitha.

Fehmi Cena - Unë më herët kur e mora fjalën fillimisht thash se do të diskutoj si delegatë e me vonë si kryesues i grupit. Megjithatë shumë çështje u shtruan dhe u sqaruan në ato vërejtje që i patëm në disa plotësisht e disa pjesërisht e që realisht për disa jemi të kënaqur e për disa jo, nuk mundem pa e përmend në emër të grupit ato vërejtje tona që i kemi pasur edhe ne të kaluarën, që po ashtu u përmenden edhe nga grupet paraprake në kuadër të shpenzimeve kapitale kemi keqklasifikime përsëri dhe duhet ta kemi të qartë dhe nuk dua të futem nëpër të gjitha ato kode që u ceken edhe me herët. Gjithashtu edhe kjo pjesa tjetër të shpenzimeve të prezantuara në formën e përgjithësuar e keni shumë dhe në shumicën e kodeve nuk keni projekte të specifikuara për ato që ne kemi kërkuar edhe me përpara. Nuk është çështja se shkelet ligji apo nuk shkelet pasi tek e fundit ajo është eporkusioni juaj mirëpo nuk duhet të vazhdoj kjo praktikë kështu pasi me tepër duhet të këtë kode me projekte të specifikuara për arsye se nëse ato nuk janë aty atëherë ne si delegatë nuk mundemi me i mbikëqyrë ato apo edhe si qytetarë të thjeshtë, prandaj kjo është ajo që vazhdimisht kemi insistuar. Edhe si delegat dhe në emër të grupit kërkojë edhe diçka nga grupi ynë për projektin që folëm me herët në pikën e dytë të rendit të ditës, si rruga e shkurtër që lidh dy rrugët me kryesore të qytetit të Rahovecit pra rruga “Dëshmorët e Pashtrikut” edhe rruga Gëzim Hamza të hyjë në projekt buxhete në mënyrë që për vitin 2021 të hapet kjo rrugë. Procedurat ligjore janë të kryera dhe ka mbet vetëm çështja buxhetore që është vetëm tek çmimi dhe komuna duhet të qëndroj pranë kësaj që mos me krijua problem pasi është projekt jetik për dy lagjet e qytetit dhe unë insistoj që kjo të hyjë në projekt buxhet.

Kryetari – Unë edhe njëherë po dua me i falënderua të gjithë për konstruktivitetin dhe idetë jashtëzakonisht interesante dhe konkrete që i kanë dhënë asamblistët duke përfshirë edhe Fehmi Cenën. Çështja e fundit që e ngriti me insistim që të futet në buxhet, departamenti i shpronësimit është një departament në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, i cili bën shpronësimin edhe vlerësimin e pronave. Pra palët kanë shprehur mospajtime me 120,000 euro që ata kanë vendosë vlere të shpronësimit dhe çështja është në procedure gjyqësore. Ne nuk mundemi ta fusim në buxhet ende kur ne momentin gjithçka është në rregull ne kete rrugë, pra ne kemi kontratë me hapë rrugën edhe me bo ndërtimin e rrugës pa asnjë problem, Ju siguroj që nuk është në kompetencat tona me fol sot pasi ne momentin kur merr epilog pozitiv kjo çështje dhe palët pajtohen atëherë ne e hapim pasi kemi kontratën për rrugë edhe nuk do ta kemi problem me trajtua si rrugë me prioritet dhe do ta hapim atë rrugë për një përdudhe dyjavore bëhet rregullimi i asaj rruge. Pra nuk është problemi te ne dhe ju kisha thënë që të mos insistoni pasi nuk mundet me qenë pjesë e buxhetit kjo rrugë dhe në momentin që vjen përgjigja në komunën e Rahovecit që gjithçka është në rregull sa i përket kësaj rruge atëherë menjëherë do ta nënshkruaj kontratën dhe mos harroni se prioritetet ne i kemi por ne prioritetet edhe kryetari e ka rolin kryesor, prandaj edhe ka ngelë kjo punë kështu dhe s'kemi nevojë me buxhetua pasi veç kemi kontratë për rrugë. Pra në momentin që merr epilog pozitiv kjo çështje atëherë unë qysh sivjet e krye atë rrugë.

Fehmi Cena – unë mendoj se me rendësi është që ajo të hyjë në projektbuxhet si kod që komuna me marr obligime edhe tek e fundit edhe nëse nuk zgjidhet kontesti siç thoni ju për vitin e ardhshëm atëherë le të zgjidhet për vitin 2022 dhe ne po e shqyrtojmë sot pasi po e kalojmë edhe kornizën afatmesme dhe nuk është vetëm buxheti për vitin 2021 por është edhe KAB-i 2021-2023 dhe të futet si zotim i komunës dhe gjithçka është rregull. Po ashtu jemi konsultua edhe me juriste edhe me ekonomistë edhe me te gjithë dhe zotimi i komunës duhet të ekzistojë.

Kryetari – Zotimi i komunës ekziston pasi është kodi i hapur për blerjen e pasurisë se paprekshme ose shpronësimin dhe unë ju siguroj që nëse nuk i kemi 120,000 për vitin e ardhshëm atëherë ju siguroj që ka mundësi me bartje të mjeteve pastaj me rishikim të buxhetit nëse do të ketë ka mundësi me i sigurua edhe të tjerët. E rëndësishme është se ne jemi këtu, pra ne kemi kodin dhe ju mund ta shihni në drejtorin për gjeodezi dhe kadastrë se ekziston kodi për shpronësime edhe kemi mjete ne to. Ne nuk e dimë se kush do të kërkoj shpronësime mirëpo ne momentin se neve na vjen vendimi që u krye kjo punë atëherë ne marrim obligim për me hapë rrugën dhe sigurisht që duhet me bo pagesën dhe ne e kemi kodin. Kapacitet e komunës për shpronësime kaq është me buxhetin që posedon por ne mundemi me shtua ende për vitin 2021 dhe sigurisht edhe me bartje të mjeteve dhe ju e dini se të hyrat e nëntorit dhe dhjetorit nuk barten fare por barten për vitin e ardhshëm edhe ato që mbledhen në mars dhe ne mundemi me bartje të hyrave prapë me ndërhy nëse do të kemi nevojë por unë shpresoj që kjo temë të zgjidhet sa më shpejtë në mënyre që ta bëjmë rrugën dhe për pastaj për shpronësim do të merremi vesh pastaj. Pra po flas në frymën e asaj që është ligjore dhe që me njerëz që merren me këto punë dhe ne momentin që i japin fund kësaj çështje dhe të bëhet pajtimi i palëve dhe ne do ta hapim rrugën.

Kryesuesi – Faleminderit shumë kryetar! Të nderuar kolegë e qesim në votim pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimin dhe aprovimin e propozim vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2021. Atëherë konstatoj se me 19 vota pro, 3 kundër dhe 6 abstenime aprovohet projektbuxheti për vitin 2021. Urime të gjithëve! Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim rregullore komunale për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Afrim Limani – Faleminderit kryesues, përshëndetje edhe njëherë të nderuar asamblistë, faleminderit shume që votuat buxhetin. Sa i përket rregullore se tatimit në pronë, ne fakt ju duhet të fokusoheni tek pjesa e fundit e këtij e materiali tek normat tatimore sepse edhe pikërisht për këtë ka ardhë edhe kjo

rregullore ne kuvend dhe ju duhet të votoni normat tatimore. Sa për informimin ju them se këto norma tatimore janë me të ulta në nivele të Kosovës dhe ju çka duhet të vendosni tash është nëse doni me ndryshua edhe ndryshimi është me rritje të normave tatimore.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues për këtë propozim rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2021. Mendoj që deri më tash është në fuqi rregullorja nr.31/57 e datës 27.11.2018 dhe pyetja ime shkon drejtpërdrejt se cili është ndryshimi i kësaj rregullore karshi rregullores se deritanishme që e kemi dhe këto normat tatimore që janë në faqen e fundit a janë të njëjta me rregulloren paraprake apo ndryshojnë.

Munib Durguti – I nderuar drejtor unë kam një pyetje për ju, se a dallojnë këto vlera tatimore prej atyre që janë aktuale, pasi aty e pamë që tatimi për shtëpi zona e parë 200 euro dhe ishin tatime shume të larta, a ka mundësi me na dhanë një sqarim rreth kësaj.

Ali Zhuniqi – Edhe unë e kam një pyetje në lidhje me këtë çështje, që sipas udhëzimit administrativ të standardeve minimale të konsultimeve publike të vitit 2018, neni 6/7 thotë që të të gjitha rregulloret duhet të kalojë në diskutim publik. Unë kam veç një pyetje që me ndryshimin e kësaj rregullore mbi tatimin mbi prona ka dal që kjo e njëjta në diskutim publik.

Afrim Limani – Pyetjen që e parashtroj z. Rasim Fazliu për dallimin rreth rregullores se re dhe rregullores ekzistuese e po ashtu të njëjtën pyetje e parashtroj edhe z. Munib Durguti. Dallimi ndërmjet rregullores se vjetër dhe të re është se rregullorja e re në vitin 2018 ka fillua se aplikuari pra ligji i tatimit në tokë dhe parcela edhe pikërisht është ky ndryshim, pasi përpara kanë qenë 3 zona kurse tani janë 6 zona, si rezultat i aplikimit të tatimit edhe ne parcela pastaj edhe ne tokë edhe ne objekte komerciale dhe industriale. Pra këtu është dallimi edhe zonat janë krijuar dhe janë të barabarta me të gjitha zonat përcaktimi i normës se tatimit. Në mbledhje të KPF-së e kam dhënë një sqarim se si janë krijuar këto zona. Krijimi i zonave është bërë nga ligjit që ka hie ne fuqi pra ligjit te tatimit në pronë të vitit 2018 dhe departamenti i tatimit në pronë në sajë të verifikimit të vet që ka bërë në terrene i ka përcaktua edhe zonat. Pra janë krijuar 6 zona në nivele të komunës se Rahovecit dhe janë gjithashtu 4 zona te tatimi i objekteve ndërsa te pronat rezidenciale industriale dhe komerciale i kemi 6 zona dhe ne këtë material e keni edhe çmimin i normës tatimore e që kuptohet shumëzohet me metër katror dhe krejt ajo që ju duhet me bo që këto norma a doni me i ndërrua apo jo, pra krejt kjo varet nga ju. Pra normat janë të njëjta vetëm se dallimi është se tash ka fillua se aplikuari edhe pjesa për parcela e oborrit nga viti 2018 dhe këtu është dallimi, se shkalla tatimore realisht nga viti 2018 është me e lirë se sa një vite përpara pasi shkalla e amortizimit përpara ka qenë te pronat rezidenciale minus 10,000 euro kurse tani minus 15,000 euro.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për sqarimin, të nderuar kolegë asamblistë, e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për shpallje qytetar nderi i Komunës se Rahovecit për z. Tomor Kotorrin.

Të nderuar kolegë e kemi trajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kemi dhanë rekomandimin kuvendit që do ta aprovojmë. E qesim në votim edhe pikën e pestë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për caktimin e komisionit ad-hoc për zgjedhjen dhe zëvendësimin e anëtarit të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Të nderuar anëtarë kuvendarë, neve na duhet që formojmë komisionin pasi që anëtari ish-kryetari i Komunës z. Esat Haxhijaha ka ndërruar jetë dhe ishte anëtar i këshillit të fshatit Hoçë e Madhe dhe duhet të zëvendësohet me anëtarin e ri. Sot në kete mbledhje duhet të caktojmë dy anëtarë nga kuvendi kurse tre me rregullore kemi nga këshilli i fshatit të cilët edhe i kemi emrat kurse na mbetet që të kemi emrat edhe nga

kuvendi. Pra kërkohen vetëm dy anëtarë dhe është komisioni kryen vetëm këtë procedure edhe pastaj shuhet. Atëherë ftojë propozimin nga AAK-ja .

Besa Bytyqi – Faleminderit kryesues, në emër të grupit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e propozoj anëtarin e AKR-së z. Bajram Morina.

Rasim Fazliu – Për përcaktimin e komisionit ad-hoc për zgjedhjen e anëtarit të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, grupi i Partisë Demokratike të Kosovës e propozon z. Fehmi Hoxha.

Kryesuesi – Atëherë i kemi dy emra që me rregullore është ashtu kur subjektet nuk kalojnë tek emri tjetër. Te nderuar kolegë, emrat që i morëm që nga grupi i AAK-së kanë propozuar z. Bajram Morina kurse nga grupi i PDK-së z. Fehmi Hoxha kurse tre anëtarë tjerë të fshatit Hoçë e Madhe janë Marko Stashiç, Ivica Miçiç dhe Ivan Sharlloviç. Të nderuar kolegë, i qesim në votim emrat e anëtarëve për formimin e komisionit. Konstatohet se unanimisht aprovohet. Tash do të hapim konkursin publik për shpalljen për aplikim dhe komisioni do të mbledhet në afatin kohor kur i njoftojmë që duhet të shqyrtojnë aplikacionet. Tani kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Raporti i Performances Komunale janar-dhjetor 2019.

Të nderuar kolegë kuvendarë, unë kisha kërkuar mirëkuptimin e kolegëve që për shkak edhe të kohës ku të gjithë e kemi pasur edhe materialin dhe si komunë kemi qenë përfitues i këtij granti e cila është mirë për qytetarët tanë dhe raporti që sot është deshtë me u prezantua është raport i brendshëm i komunës tonë kurse raporti nga MAPL-ja është publik nga data 7-të të këtij muaji edhe në webfaqe të komunës dhe unë uroj që vitin tjetër të jemi edhe më të suksesshëm dhe të renditemi në vendin e parë. Të nderuar kolegë kuvendarë, faleminderit shumë të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoj 14:00

01-Nr.113/20

Datë:29.10.2020

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

